

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5670
E martë, 8 janar 2019
çmimi 0.40 €

Izet Demaj shpallet zyrtarisht 'Hero i Kosovës'



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

NARKOZA E VIZAVE - MIT APO REALITET

F. 10

Shkruan:
Agron HOTI



BANORËT KËRKOJNË QË SHKOLLA E TYRE TA KETË EMRIN E PATRIOTIT JANUZ BAJÇINCA

F. 6

ISA MUSTAFA FLET PËR SËMUNDJEN NGA E CILA VUAN QË NJË VIT

F. 7

EKONOMI

OAK-U: TË LIROHET LËNDA E PARË PËR PRODHUESIT

F. 8

EFEKTI I TAKSËS: KOSOVA IMPORTOI 10 MILIONË KILOGRAMË GRURË MË PAK NGA SERBIA

F. 8

KULTURË

INTERVISTË ME AKADEMIK
MEHMET KRAJËN (3)

LETËRSIA BRENDA VETES NUK I NJEH PËRKUFIZIMET TEORIKE

F. 16

SPORT

VAZHDON 'GJAHU' I KLUBEVE TË SUPERLIGËS

F. 20



FLET PËR "EPOKËN E RE", BESNIK BISLIMI

FAQE 4-5

Ekipi negociator nuk e ka mbështetjen e shumicës shqiptare

Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Besnik Bislimi, ka vlerësuar se vetëm kjo parti ka seriozitetin që e meriton faza finale e dialogut me Serbinë. Ai ka treguar se kjo është arsyeja pse insistojnë që në këtë proces Kosova të hyjë e përgatitur mirë dhe politikisht e fuqishme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bislimi ka theksuar se falë angazhimit të Vetëvendosjes dhe mbështetjes qytetare dialogu me Serbinë nuk ka vazhduar dhe presidentit Thaçi i është pamundësuar aventura. Bislimi ka thënë se iniciativa e PSD-së e ka rikthyer sërish në skenë Thaçin duke i ofruar atij perceptimin e një mbështetje të gjerë nga Kuvendi

Presidenti dhe Qeveria nuk flasin njëjtë për heqjen e taksës

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka paralajmëruar se Kosova është e gatshme ta shqyrtojë taksën prej 100 përqindësh për mallrat serbe nëse plotësohen disa kushte, por Qeveria e Kosovës e ka kundërshtuar një gjë të tillë. Sipas shefit të shtetit, taksë mund të diskutohet nëse Kosovës i jepet një rrugë e qartë drejt arritjes së një marrëveshjeje finale me Serbinë e



cila garanton njohjen reciproke. Mirëpo disa zyrtarë të lartë qeveritarë nuk janë pajtuar me një gjë të tillë, duke thënë se ajo nuk është vënë për t'u hequr

FAQE 3

Sfidë për ATK-në mbetet zbatimi i strategjisë së rrezikut institucional

FAQE 8-9



Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Sakip Imeri, në një bisedë për gazetën "Epoka e re" ka thënë se sfida për institucionin të cilin e drejton mbeten zbatimi i strategjisë së rrezikut institucional si dhe përmirësimi i kapacitetit për modernizim

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Delegacioni shtetëror për dialog sot takohet me Mogherinin në Bruksel

Delegacioni shtetëror i Kosovës për bisedime me Serbinë sot (e martë) pritet të takohet me shefen për politikë të jashtme të Bashkimit Evropian (BE), Federica Mogherini.

Zëdhënësja e kësaj të fundit, Maja Kocijançiq, ka thënë se ky takim është mundësi për normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi

"Epoka e re"

PRISHTINË, 7 JANAR - Delegacioni shtetëror i Kosovës për bisedime me Serbinë, i kryesuar nga Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti, pritet që sot (e martë) të zhvillojë një takim në Bruksel me shefen për politikë të jashtme të BE-së, Federica Mogherinin. Zëdhënësja e BE-së, Maja Kocijançiq, ka thënë për "KlanKosova" se pritet angazhim i tyre sa i përket procesit të çështjes së dialogut. Angazhim të tillë, sipas Kocijançiqit, duhet të ketë edhe nga pala serbe, duke qenë se një normalizim i plotë i marrëdhënieve mes të dyja vendeve është i nevojshëm për të qenë pjesë e BE-së. "Delegacioni u

ftua në Bruksel për t'u takuar më 8 janar dhe do të pritet, po ashtu, nga shefja për politikë të jashtme, Federica Mogherini", është shprehur ajo.

Kocijançiqi ka thënë se këto konsultime janë pozitive për të ardhmen dhe angazhimin e palës së Kosovës në këtë drejtim. "Konsultimet janë një mundësi për t'i shkëmbyer qëndrimet me përfaqësuesit e Kosovës në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit, të lehtësuar nga Bashkimi Evropian", është shprehur ajo. Ditë më parë zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, një nga kryesuesit e delegacionit, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ky takim do të jetë për ta njoftuar Brukselin me delegacionin si



dhe për ta treguar përkushtimin, vendosmërinë dhe seriozitetin e Kosovës për dialog. "Në dhjetëditëshin e parë të janarit presim të udhëtojmë për Bruksel. Takimi është për ta njoftuar Brukselin me delega-

cionin si dhe për ta treguar përkushtimin, vendosmërinë dhe seriozitetin tonë për dialog. Aty do t'i paraqesim idetë se si e shohim platformën e dialogut, por presim edhe nga Brukseli që të paraqesë vetë se si e shih

pjesën finale të dialogut në mes të dy vendeve", ka thënë Limaj. Delegacioni i shtetëror i Kosovës këtë herë do të zhvillojë takim me Federica Mogherinin pa praninë e presidentit Hashim Thaçi.

Studentët në Shqipëri rinisin protestat

TIRANË, 7 JANAR - Studentët e universiteteve publike rifilluan protestat me kërkesat e tyre ekonomike dhe akademike, duke mbushur plot një muaj bojkot të ligjëratave. Ata kërkojnë uljen e tarifave universitare, rritjen e buxhetit për arsimin dhe pjesëmarrje në institucionet vendim-marrëse të universiteteve. Qeveria mori një seri vendimesh për studentët në mbledhjen e fundit, por studentët pohojnë se ato nuk i plotësojnë kërkesat e tyre. Në mbledhjen e fundit të dhjetorit qeveria mori 11 vendime për studentët e rezultateve të larta dhe ata në nevojë, që do të përfitojnë arsim falas dhe bursa mujore. Për studentët e programeve master me rezultate të larta tarifa ulet 50%. Studentët nga familje në ndihmë ekonomike, të verbrit, paraplegjikë e tetraplegjikë financohen tani nga shteti 100% në tarifën e regjistrimit. Po ashtu edhe studentët me nota të larta në çdo program studimi. Studentët e tjerë përfitojnë financimin 50% të tarifës së

regjistrimit, me kusht që gjatë studimeve të mbajnë një mesatare mbi 6 të notave. Tarifat e studimeve master paguhën 50 për qind nga qeveria për studentët me nota të larta, ata nga familje në ndihmë ekonomike, të verbrit, paraplegjikë e tetraplegjikë, jetimë, fëmijët e policëve të vrarë.

Vendimet e tjera parashikojnë përfitime të ndryshme në jetën konviktore dhe në atë të auditoreve, transparencën buxhetore dhe atë akademike në lidhje me pedagogët. Por studentët rifilluan protestat sepse, siç thonë, kërkesat e tyre kanë të bëjnë me të drejtat e tyre universale njerëzore për shkollim dhe jo një sistem shpërblimesh për më të mirët, siç e shih qeveria çështjen.

PD: Rama nuk do t'i plotësojë kërkesat e studentëve

Tiranë, 7 janar - Edi Rama nuk ka ndërmend t'i plotësojë kërkesat e studentëve, tha të hënën



përmes një deklaratë për shtyp, zëdhënësja e Partisë Demokratike, Ina Zhupa. Kjo, sipas saj, "për një arsye të thjeshtë, sepse aty nuk ka aq shumë lekë për të vjedhur". "Lekët e studentëve kryemi-

nistri i ka vjedhur prej kohësh përmes Ligjit të Arsimit të Lartë dhe sot vetëm tallet me studentët. Për Edi Ramën ka rëndësi vetëm ruajtja e standardit të jetës mes luksit. Kryeministri ka detyrimin të shpjegojë pse luksi

real dhe pasuria e tij nuk përputhen me deklaratën e pasurisë", u shpreh Zhupa. Sipas PD-së, fshehja e pasurisë është arsyeja përse Edi Rama votoi kundër vetingut të politikanëve.

Institucionet e Kosovës kanë mendime të ndryshme rreth mundësisë së heqjes së taksës për mallrat serbe

Presidenti dhe Qeveria nuk flasin njëjtë për heqjen e taksës



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka paralajmëruar se Kosova është e gatshme ta shqyrtojë taksën prej 100 përqindësh për mallrat serbe nëse plotësohen disa kushte, por Qeveria e Kosovës ka kundërshtuar një gjë të tillë. Sipas shefit të shtetit, taksa mund të diskutohet nëse Kosovës i jepet një rrugë e qartë drejt arritjes së një marrëveshjeje finale me Serbinë, e cila garanton njohjen reciproke. Mirëpo disa zyrtarë të lartë qeveritarë nuk janë pajtuar me një gjë të tillë, duke thënë se ajo nuk është vendosur për t'u hequr

me Serbinë, i kam thënë gazetës 'The Washington Post', duke kërkuar që ShBA-ja të marrë rol udhëheqës në koordinimin e inputit ndërkombëtar për marrëveshjen paqësore finale që do ta sjellë njohjen e Kosovës nga Serbia. Ndërgjegjja jonë na kërkon dhe është detyrë e jona historike që të bëjmë paqen të mundshme dhe të vërtetë", ka shkruar presidenti i vendit në profilin e vet në "Facebook". Por i menjëhershëm ka qenë reagimi i Qeverisë së Kosovës për këtë çështje. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, ka thënë se presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, nuk mund të japë premtime të tilla për heqjen e taksës ndaj shtetit të Serbisë. "Përderisa ekzistojnë arsyet të cilat neve si Qeveri e Republikës së Kosovës na kanë shtyrë ta vendosim këtë taksë, do të thotë arsyet të cilat unë i kam prezantuar, kur e kam propozuar vendimin për këtë taksë, atëherë asnjëherë kjo taksë nuk do të eliminohet", ka

deklaruar ministri Shala për "Kallxo.com".

Ai ka deklaruar se deri në këto momente nuk kanë pranuar një kërkesë të tillë as nga presidenti e as nga delegacioni i Kosovës për dialog me Serbinë. "Presidenti tash s' di çka po merret me këto punë. Këto janë punë të delegacionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për negociatë. Kur ata na sjellin neve si qeveri një kërkesë, ku thonë se kjo taksë duhet të hiqet për arsye se kemi arritur ta realizojmë këtë... E realizimi i tyre nënkupton arsyet që na kanë shtyrë neve ta vëmë taksën, atëherë unë si ministër i Tregtisë mund të propozoj ta heqim një taksë të tillë", ka thënë Shala.

Edhe zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Burim Ramadani, ka thënë se taksa ndaj produkteve serbe nuk do të hiqet pa ndryshuar të gjitha rrethanat. "Taksa 100 për qind nuk është vënë për t'u hequr pa ndryshuar plotësisht rrethanat. Njohja e Serbisë për shtetin e

Kosovës, sipas 17 shkurtit 2008, hap mundësinë për të diskutuar, jo anasjelltas. Siguria kombëtare nuk vihet në kalkulime", ka shkruar Ramadani në llogarinë e vet në "Facebook".

Qeveria e Kosovës në nëntor të vitit të kaluar ka vendosur taksë 100 për qind në importet që vijnë nga Serbia dhe Bosnje Hercegovina në Kosovë. Ndërsa në muajin dhjetor ekzekutivi ka vënë masën e njëjtë edhe për brendet ndërkombëtare që prodhohen në Serbi, duke fuqizuar këtë vendim nga 1 janari i këtij viti. Këto veprime të Qeverisë nuk janë pritur mirë nga bashkësia ndërkombëtare. Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës vazhdimisht kanë kërkuara nga Qeveria që të hiqet kjo taksë ose të suspendohet përkohësisht. Ky vendim i Qeverisë së Kosovës ka ardhur pas një ofensive të shtetit serb kundër Kosovës në arenën ndërkombëtare, e cila kulmoi me mospranimin e Kosovës në Interpol.

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 7 JANAR - Qeveria e Kosovës nuk është pajtuar me paralajmërimin e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, i cili ka paralajmëruar se taksa prej 100 përqindësh për mallrat serbe mund të hiqet nëse plotësohen disa kushte.

Shefi i shtetit, Hashim Thaçi, ka

thënë për gazetën amerikane "The Washington Post" se Kosova është e gatshme ta shqyrtojë taksën në importet serbe në rast se ekziston një rrugë e qartë drejt arritjes së marrëveshjes me Serbinë. "Kosova është gati ta shqyrtojë heqjen e taksës për produktet serbe nëse Kosovës i jepet një rrugë e qartë drejt arritjes së një marrëveshjeje finale paqësore

Mobilizimi kundër Vuçiqit, në rritje

PARIS, 7 JANAR - Në Serbi është në rritje mobilizimi kundër "regjimit autoritar" të presidentit serb Aleksandër Vuçiq dhe duket se frika po zhduket për shkak se çdo të shtunë mbledhen një numër në rritje i njerëzve. Kështu kanë shkruar mediet franceze të cilat i kanë kushtuar vëmendje të

madhe protestave kundër presidentit serb.

Gazeta "Le Figaro" ka shkruar se të shtunën e kaluar, e shtuna e pestë me radhë janë mbledhur dhjetëra-mija njerëz në Beograd pavarësisht motit të ftohtë dhe festimit të Krishtlindjeve.

"Figaro" ka theksuar se tensionet

janë rritur më tej kundër Qeverisë dhe presidentit Vuçiq pas sulmit në kreun e opozitës në Serbi, Borko Stefanović, Gazeta franceze ka kujtuar se një grup studentësh kanë organizuar protesta. I njëjti grup sipas kësaj gazete ishte edhe në pranverën e vitit 2017, kundër zgjed-

hjes së Vuçiqit me moton "kundër diktaturës".

Gazeta tjetër franceze "Le Point" ka shkruar se protestat në Serbi po vazhdojnë kundër regjimit të Vuçiqit, duke shtuar se organizatorët kanë deklaruar se protestat do të mbahen çdo të shtunë deri sa kërkesat e tyre të plotësohen.



Flet për "Epokën e re", Besnik Bislimi

Ekipi negociator nuk e ka mbë

Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Besnik Bislimi, ka vlerësuar se vetëm kjo parti ka seriozitetin që e meriton faza finale e dialogut me Serbinë. Ai ka treguar se kjo është arsyeja pse insistojnë që në këtë proces Kosova të hyjë e përgatitur mirë dhe politikisht e fuqishme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bislimi ka theksuar se falë angazhimit të Vetëvendosjes dhe mbështetjes qytetare dialogu me Serbinë nuk ka vazhduar dhe presidentit Thaçi i është pamundësuar aventura. Bislimi ka thënë se iniciativa e PSD-së e ka rikthyer sërish në skenë Thaçin duke i ofruar atij perceptimin e një mbështetje të gjerë nga Kuvendi

**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 7 JANAR - Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Besnik Bislimi, ka thënë të hënën se sondazhi i fundit që ka nxjerrë Vetëvendosjen partinë e dytë në Kosovë prezanton situatën në terren. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se Vetëvendosja në vazhdimësi po konsolidohet dhe po fuqizohet. "Ky fuqizim manifestohet si në shtimin rekord të numrit të anëtarëve tanë, po ashtu edhe në rritjen e pikave të reja të themeluara anekënd Kosovës. Nga ky këndvështrim, mbase një kontribut kyç u takon edhe atyre që kanë vendosur të dalin nga Lëvizja në fillimin e vitit 2018", ka deklaruar Bislimi.

Duke folur për dialogun me Serbinë ai ka thënë se vetëm Vetëvendosja ia atribuon seriozitetin që e meriton faza finale e këtij procesi. "Kjo është arsyeja pse në insistojmë që në këtë proces të hyjmë të mirëpërgatitur dhe politikisht të fuqishëm. Kusht për një



proces nga i cili nuk do të dilte një kompromis i dhimbshëm, për të cilin na flasim Qeveria dhe presidenti, janë hapat që kemi përsëritur ditë për ditë sa herë që na është dhënë mundësia", është shprehur Bislimi, duke

shtuar se falë angazhimit të Vetëvendosjes dhe mbështetjes qytetare dialogu me Serbinë është ndërprerë dhe presidentit Thaçi i është pamundësuar vazhdimi i aventurës. Mirëpo, sipas tij, iniciativa e PSD-së e ka

rikthyer sërish në skenë Thaçin, duke i ofruar atij perceptimin e një mbështetje të gjerë nga Kuvendi. Megjithatë, Bislimi ka deklaruar se kjo farsë nuk do të 'dhezë' meqë, sipas tij, shumica shqiptare nuk e mbështet

presidentin dhe ekipin negociator në çfarëdo vendimi që ata do të guxojnë të marrin. Nënkryetari i Vetëvendosjes ka paralajmëruar shtim të bashkëpunimit opozitar Vetëvendosje - LDK.

shtetjen e shumicës shqiptare

Albin Kurti është kandidati më i preferuar i qytetarëve për kryeministër. Me këtë sondazh nuk janë pajtuar subjektet e tjera politike.

Bislimi: Sondazhi nuk është fontanë dëshirash me të cilën pajtohesh ose jo. Sondazhi prezanton situatën në terren. Krejt çfarë u mbetet subjekteve të tjera është ta kontestojnë metodologjinë e përdorur, por këtë nuk e ka bërë askush meqë secili subjekt e di që në Kosovë nuk ka asnjë institut më profesional se 'UBO Consulting' kur bëhet fjalë për sondazhe të tilla. Ta mohosh realitetin nuk është karakteristikë e individëve racionalë.

"Epoka e re": Pavarësisht prej këtij sondazhi, cila është gjendja reale në terren e Lëvizjes Vetëvendosje? Ka arritur të konsolidohet pas ndarjes dhe largimit të 13 deputetëve?

Bislimi: Lëvizja Vetëvendosje në sondazhet e organizuara para zgjedhjeve të qershorit 2017 ka pasur më pak se ajo që prezantuar dje. Por, tri elemente janë me peshë: Lëvizja rritet shumë gjatë muajit të fushatës zgjedhore falë kristalizimit të pozicioneve tona qoftë nëpër prezantime publike, qoftë nëpër debate televizive; Lëvizja fuqizohet si reflektim i reagimit të qytetarëve ndaj koalicioneve joparimore që arrihen zakonisht në minutat e fundit mes subjekteve që kanë interes zhvatjen e publikes; dhe Lëvizja merr mbështetje shumë të fuqishme nga diaspora, votat e së cilës nuk pasqyrohen nëpër këto sondazhe të brendshme. Në fund të vitit 2018 kemi prezantuar edhe të dhënat që flasin me precizitet për konsolidimin dhe fuqizimin e Lëvizjes në terren, fuqizim ky që manifestohet si në shtimin rekord të numrit të anëtarëve tanë, po ashtu edhe në rritjen e pikave të reja të themeluara anekënd Kosovës. Nga ky këndvështrim, mbase një kontribut kyç u takon edhe atyre që kanë vendosur të dalin nga Lëvizja në fillimin e vitit 2018.

"Epoka e re": Z. Bislimi, si i komentoni zhvillimet e fundit në skenën politike të Kosovës, përkatësisht vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi?

Bislimi: Dialogu me Serbinë nuk ka vazhduar falë zhveshjes complete që i kemi bërë ne partitë opozitare aventurës së presidentit Thaçi dhe falë sinjalit të fuqishëm që populli i ka dërguar klasës së korruptuar

politike në protestën e 29 shtatorit. Përmes demaskimit komplet të synimeve shumë të dëmshme të sponsorizuara nga Beogradi e Moska, përmes presidentit tonë, ne kemi arritur që Thaçi të mbetet krejtësisht i izoluar, i paafte për ta vazhduar aventurën e tij dhe komplet i devaluuar në rrafshin ndërkombëtar.

"Epoka e re": Çështja e dialogut tashmë është kthyer në Kuvend dhe është krijuar një ekip negociator, pjesë e të cilit është edhe një parti opozitare, PSD-ja. A do të mund ky ekip ta përfundojë me sukses fazën finale të dialogut me Serbinë?

Bislimi: Së pari është logjikë e gabuar që PSD-ja të radhitet si subjekt politik opozitar. Madje me një kualifikim të tillë nuk do të pajtoheshin as vetë eksponentët e PSD-së. Madje një prej tyre publikisht ka deklaruar me mburrje që falë vizionit të tyre kanë shtyrë përpara edhe çështje që opozita nuk ka arritur të bëjë, duke aluduar në subjektet e tjera opozitare. Por është e saktë se ka qenë iniciativa e PSD-së që e ka rikthyer sërish në skenë Thaçin duke i ofruar atij perceptimin e një mbështetje të gjerë nga Kuvendi. Është krejt e natyrshe që kjo farsë nuk do 'dhezë' meqë është shumë e qartë që shumica shqiptare nuk e mbështet këtë president,

as këtë ekip negociator në çfarëdo vendimi që ata do të guxojnë të marrin. Duhet të konstatojmë edhe një gjë, vetë iniciativa e PSD-së ka synuar një ekip negociator ku nuk figuron as LDK-ja e as LV-ja meqë në një konstelacion të tillë ata do të zhvendoseshin në periferi të zhvillimeve. Një muaj para se ta sjellin në Kuvend propozimin e tyre rreth ekipit negociator, kryesia e PSD-së ka votuar për Shpend Ahmetin si bashkëkryesues i ekipit, votim që do të ishte i palogjikshëm sikur ata të kishin shpresuar sadopak që LDK-ja dhe/apo LV-ja do të vendosnin t'i bashkëngjiteshin kësaj ideje.

"Epoka e re": Pse Lëvizja Vetëvendosje është kundër procesit të dialogut dhe kundër përfshirjes në këtë ekip?

Bislimi: Ky është interpretim thelbësish i gabueshëm i pozicionit të Lëvizjes Vetëvendosje në raport me dialogun. Në fakt, mund të thuhet se vetëm LV-ja ia atribuon fazën finale të dialogut nivelin e seriozitetit që e meriton. Kjo edhe është arsyeja pse insistojmë që në këtë proces të hyjmë të përgatitur mirë dhe politikisht të fuqishëm. Kusht për një proces nga i cili nuk do të dilte një kompromis i dhimbshëm, për të cilin na flasin Qeveria dhe presidenti, janë hapat që kemi përsëritur ditë për ditë sa herë

që na është dhënë mundësia. Nuk ka sens politik që të emërohet ekipi negociator, e sidomos jo të publikohet pozicioni yt fillestar i prezantuar si draft marrëveshje finale pa bërë një rivlerësim të fazave të deritanishme të dialogut dhe pa definuar qartë listën e kërkesave dhe pritjeve tona nga dialogu. E sidomos nuk ka sens politik të dërgojmë në negociata individë e subjekte pa testuar peshën e tyre politike, apo individë që përfaqësojnë negacionin e unitetit të brendshëm.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh se as LV-ja e as LDK-ja nuk do të jenë pjesë e këtij procesi, a do të ketë shtim të bashkëpunimit në mes të këtyre dy partive qoftë sa i përket dialogut, qoftë edhe për çështje të tjera?

Bislimi: Bashkëpunimi opozitar është më se i natyrshtë, sidomos në një ambient politik si ky që kemi në Kosovë, ku skandali politik është norma e politikbërjes nga ana e Qeverisë dhe presidencës, dhe ku shkurtimi i jetës së Qeverisë është imperativ dhe interes primar i secilit qytetar. Natyrisht se ka hapësirë dhe domosdoshmëri edhe për më shumë forcim, por zakonisht për afrimet e tilla nuk janë të lehta dhe kërkojnë pak më shumë kohë.

Zëdhënësi i FSK-së: Emblema është origjinale dhe ne e respektojmë atë

PRISHTINË, 7 JANAR - Zëdhënësi i Forcës së Sigurisë të Kosovës, Ibrahim Shala, ka thënë se emblema të cilën e bartin ushtarët e Kosovës është origjinale. Për shkak të festës zyrtare Shala ka thënë se nuk mund ta japë detaje të hollësishme lidhur me këtë çështje. Mirëpo, ai për "KlanKosova.tv" ka shtuar se brenda FSK-së do të diskutohet lidhur me raportimet se kjo emblemë është kopjuar nga një kompani amerikane e sigurisë dhe porsa të arrihet një qëndrim i qartë, ai do t'u kumtohet gazetarëve. "Emblemën të cilën e ka sot FSK-ja është emblemë origjinale dhe ne e respektojmë atë. Ne do të diskutojmë lidhur me këtë çështje gjatë ditëve në vijim dhe do t'i njoftojmë mediat për çfarëdo qëndrimi që arrihet", ka thënë Shala.



"Epoka e re": Z. Bislimi, të dielën keni prezantuar rezultatet e një ankete, sipas së cilës, nëse zgjedhjet parlamentare do të mbaheshin tani, Lëvizja Vetëvendosje do të merrte 22.6 për qind të votave, kurse lideri

Banorët kërkojnë që shkolla e tyre ta ketë emrin e patriotit Januz Bajçinca

Nëpërmjet peticionit, nga udhëheqja e Komunës së Lipjanit, konkretisht nga Kuvendi Komunal, është kërkuar mbështetja e kërkesës së banorëve për vënien e emrit të shkollës të patriotit Januz Bajçinca dhe t'i hiqet emri që e mban prej shumë vitesh "Drita". Mirëpo, kohë më parë, përkundër asaj që në mbledhjet e Kuvendit nuk kaloi kjo kërkesë, banorët janë këmbëngulës se nuk do të lëshojnë pe deri në realizimin e kërkesës së tyre



Shkolla e vjetër fillore e dy fshatrave të Rubovcit të Komunës së Lipjanit

kësaj iniciative për emërimin e shkollës me emrin e patriotit Januz Bajçinca u deklaruan edhe të intervistuarit e tjerë, si: Jahir Zaskoku, Ekrem Zaskoku, Ruzhdi Bajçinca e të tjerë. Me një fjalë, tërë banorët e tri fshatrave të cekura më lart. "Do të kërkohet në të gjitha instancat e vendit që kjo kërkesë të bëhet realitet sa më parë, sepse është kërkesë e mbi 95 për qind e banorëve që shkolla të pagëzohet me emrin Januz Bajçinca", ka pohuar ndër të tjera

ai, që edhe është iniciatori kryesor i kësaj iniciative.

Januz Bajçinca qysh në fillim të vitit 1941 kishte mbajtur kontakte me krerët e pushtetit italo-shqiptar në Lipjan e më gjerë, pra fillimisht me Adem Selim Gllavicën, Qazim Sefë Llugaxhinë, me luftëtarin më të përkushtuar të asaj kohe, Hysen Tërpezën, Bahti Tërpezën e shumë të tjerë.

Qysh në verë të vitit 1941 Januzi kishte shpalosur flamurin kom-

bëtar në fshatin e tij dhe i kishte ftuar bashkëfshatarët ta përkrahin pushtetin, i cili kishte dëbuar nga Kosova regjimin anti-shqiptar të Jugosllavisë. Me qëllim për ta forcuar luftën dhe qëndresën, në radhët e forcave vullnetare të kohës ai angazhoi dy bijtë, Ruzhdiun dhe Nebihun.

Në rrethin e Lipjanit asokohe njiheshin si luftëtarë të shquar nacionalistë, Kadri Beba i cili me vendim të Ilaz Agushit ishte emëruar kryetar i komunës, pastaj Salih Rexh Ribari, komandant i forcave vullnetare nga rrethina e Lipjanit në Frontin e Prapashticës, Ismajl Dragusha dhe Shaban Dragusha nga Rufci i Vjetër, Islam Domaneku nga Gracka, Adem Gllavica, Qazim Llugaxhia, Qerim Selimi, Idriz Mehmeti nga fshati Banullë-Lipjan. Zekë Luma nga Kraishta, Nezir Buja nga Bujani, Rexhep Sali Rexha nga Ribari i Madh, Shaban Dragusha nga Rufci, Habib Emini nga Banulla, Ilaz Sadiku nga Hallaqi, Hajredin Mëziu nga Vërsheci, Bajram Cykovci nga Cërnilla, Qazim Leskovci nga Mirashi, Hajredin Avdyli nga Sazlia, Nebij Januzi e Ruzhdi Januzi të dy nga Rubovci, Tahir Prokupja nga Fusha e Madhe, Miftar Gashi, Dobrajë Beqë Zeqiri Gjyrcok, Idriz Hysen Bislimi nga Gadimja, Rexhep Akllapi, Xheladini e Idrizi nga Sllovija, Hasani nga Gadimja, Musli Mikulani nga Dobraja e Madhe e shumë të tjerë, thuhet në librin e Ahmet Qeriqit "Januz Bajçinca me të bijtë, Ruzhdiun dhe Nebihun".

Për veprën patriotike të Januz Bajçincës kanë folur disa historianë të njohur të cilët me shënime të sakta për këtë patriot, pohuan se veprimtaria e tij kombëtare nuk përfundon edhe me qindra faqe të shkruara. Në një studim të gjatë për veprimtarinë e veprimtarit në fjalë, profesori i historisë, Adem Tasholli, ndër të tjera, citon: "Në mesin e shumë luftëtarëve të NDSH-së, trim i rrallë u dallua edhe Januz Bajçinca".



Nasri Bajçina, nipi i Januz Bajçincës

Bajçinca dhe t'i hiqet emri që e mban prej shumë vitesh "Drita". Mirëpo, kohë më parë, përkundër asaj që në mbledhjet e Kuvendit nuk kaloi kjo kërkesë, banorët janë këmbëngulës se nuk do të lëshojnë pe deri në realizimin e kërkesës së tyre.

Ekrem Budakova nga fshati Rubovc ka thënë se banorët kërkojnë nga Komuna e Lipjanit

EPOKA
ERE

Ismail REXHEPI

LIPJAN, 7 JANAR - Ka kohë që banorët e tri fshatrave të Komunës së Lipjanit, Rubovc i Madh, Rubovc i Vogël dhe Kajskë, po kërkojnë që shkollës së tyre t'i vihet emri i patriotit të njohur të NDSH-së, Januz Bajçinca. Iniciativa e dalë nga nipi i tij,



Pamje e fshatit Rubovc

Nasri Bajçinca, përnjëherë me të kuptuar banorët e fshatrave në fjalë, e përqaftuan këtë ide të tij. Pra, për një kohë të shkurtër e nënshkruan peticionin mbi 95 për qind të banorëve të këtyre tri fshatrave.

Nëpërmjet peticionit, nga udhëheqja e Komunës së Lipjanit, konkretisht nga Kuvendi Komunal, është kërkuar mbështetja e kërkesës së banorëve për vënien e emrit të shkollës të patriotit Januz

që ta përmbushë kërkesën e tyre për vënien e emrit të shkollës të patriotit Januz Bajçinca. "Kjo kërkesë duhet të realizohet se është kërkesë e drejtë të cilën e kërkojnë banorët të bëhet realitet", ka thënë ai.

Basri Rudari, gjithashtu nga i njëjti fshat, është deklaruar se është me këmbëngulje për vënien e emrit të shkollës të patriotit shqiptar Januz Bajçinca. "E mbështes kërkesën në fjalë", ka thënë Rudari. Po ashtu, pro

Liburn Aliu reagon për mospërfshirjen e Luginës në ekipin negociator

PRISHTINË, 7 JANAR (ER) - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje!, Liburn Aliu, ka mbajtur të hënën konferencë për media në lidhje me mospërfshirimin e Kosovës Lindore në negociatën me Serbinë. Ai ka thënë se duke u mbështetur në rezolutën e miratuar në Kuvendin e Kosovës, ku nuk figuron fare fjala reciprocitet, 'delegacioni shtetëror' po e thellon këtë proces dialogu disaveçar në të cilin Kosova vazhdimisht ka bërë kompromise me kërkesat e Serbisë ndaj saj. "Si bëhet që në të ashtuquajturin 'delegacion

shtetëror' të Kosovës kemi aq shumë përfaqësues partish që s'e kalojnë pragun zgjedhor, mirëpo aty nuk janë përfaqësuesit e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit? Pse në delegacion të mos jenë kryetari i Preshevës, kryetari i Bujanocit, kryetari i Këshillit Nacional Shqiptar, deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, dhe asamblisti shqiptar në Medvegje?", ka thënë ai. Aliu ka thënë se Thaçi në konferencat për media në Prishtinë e përmend Kosovën Lindore, por jo me diplomatët perëndimorë.

"Me ata flet për heqjen e taksës 100 për qind ndaj Serbisë, sikurse që bëri në takimim me ambasadorin amerikan në Berlin në fund të dhjetorit 2018. Në Atlantic Council në Washington D.C., në kryeqytetin e ShBA-ve, për plot 55 minuta ligjëratë dhe pyetje-përgjigje, asnjëherë nuk e përmendi, se lëre më ta trajtojë, Preshevën, Medvegjën e Bujanocin. Thaçi me Vuçiqin flet për veriun e Kosovës e për Rusinë. Por asnjëherë nuk ia kërkoi atij Kosovën Lindore që mbahet e shtypur, e diskriminuar dhe e



shfrytëzuar pikërisht nga shteti i Serbisë në krye të së cilit është

Vuçiq", ka thënë deputeti Liburn Aliu.

Isa Mustafa flet për sëmundjen nga e cila vuan që një vit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 JANAR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, sot i ka bërë një vit që vuan nga një sëmundje shumë e rrallë e cila njihet si "Sindromi Gulian Barren". Në profilin e vet në "Facebook", Mustafa ka shkruar se gjendja e tij po përmirësohet gradualisht, duke i falënderuar të gjithë ata që janë përkujdesur për të gjatë kësaj kohe. Sipas tij, diagnozën e sëmundjes së tij e ka identifikuar një doktor në Spitalin Amerikan. "Sot mbushet një vit i përballjes sime me rehabilitimin shëndetësor. Në mbrëmjen e 7 janarit 2018 sa isha në fshat ndjeva se po humbi fuqinë e duarve dhe të këmbëve. Pas 24 orëve në Spitalin Amerikan, dr. Blerim Myftiu identifikoi diagnozën e saktë, Sindromin Gulian Barren dhe shkroi terapinë e nevojshme. Në Gjermani ishin të habitur për identifikimin e shpejtë që iu bë

nga mjekët kosovarë kësaj sëmundjeje shumë të rrallë (një deri dy raste në njëqindmijë banorë). Sot, kur po shkruaj me duart e mia, shfrytëzoj rastin ta falënderoj ekipin e mjekëve dhe infermierëve të Spitalit Amerikan në Prishtinë, që në ditët e para të sëmundjes u përkujdesën për mua, të falënderoj prof. dr. Halill Krasniqin për kujdesin e vazhdueshëm sa isha i shtruar në Qendrën e Rehabilitimit "Quellenhof" në Bad Vil Baden të Gjermanisë, veçmas prof. dr. Afrim Gashin dhe ekipin e shkëlqyeshëm të fizioterapeutëve në Prishtinë, Nadira Boshnjaku dhe Amir Tyrbetarin dhe nipin tim Feti Gashin", ka thënë Mustafa.

Ai ka shtuar se gjatë gjithë kësaj kohe, edhe pse një periudhë ishte krejtësisht i palëvizshëm nga duart dhe këmbët, kishte kurajë të sfidohet me këtë sëmundje. "Kisha besim në Zotin, në veten time dhe në mjekët se do të rikuperohem. Gjatë gjithë kësaj kohe nuk kam pushuar së punuari dhe



lexuari. Rikthimi po vjen ngadalë, me rendin e vet", ka thënë lideri i LDK-së, Isa Mustafa. Ai ka falënderuar familjen e ngushtë që nuk e ka lënë asnjë minutë vetëm, qoftë në Spitalin Amerikan, pastaj tre muaj në Gjermani dhe tani në

Prishtinë. Mustafa ka falënderuar edhe bashkëpunëtorët nga LDK-ja, nga ASHAK-u, Fakulteti Ekonomik, përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës, të Republikës së Shqipërisë dhe liderët politikë

shqiptarë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe Lugina e Preshevës të cilët, siç ka thënë ai, "më dhanë kurajë gjatë kësaj periudhe. Veçmas falënderoj fqinjët, qytetarët dhe bashkatdhetarët për interesimin e tyre".

Izet Demaj shpallet zyrtarisht 'Hero i Kosovës'



PRISHTINË, 7 JANAR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, duke u bazuar në nenin 84 (28) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 6

të Ligjit nr. 03/L-094 për presidentin e Republikës së Kosovës, gjithashtu në nenin 6 të Ligjit nr. 04/L-070 për Dhënien e Dekorativë dhe në Rregulloren

(P) nr. 04/2016, për policin e rënë heroikisht në krye të detyrës dhe në mbrojtje të qytetarëve, Izet Demaj, ka ndarë urdhrin "Hero i

Kosovës". Urdhri "Hero i Kosovës" u jepet personave që kanë bërë vepra trimërie dhe sakrifice, si dhe që kanë dëshmuar veprimtari ose

akte të guximit qytetar në kohë lufte apo paqeje. Vendimi, certifikata dhe urdhri "Hero i Kosovës" do t'i dorëzohen familjes Demaj.

Flet për "Epokën e re", Sakip Imeri

Sfidë për ATK-në mbetet zbatimi i s



Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Sakip Imeri, ka bërë me dije se sfida për institucionin të cilin e drejton mbetet zbatimi i strategjisë së rrezikut institucional si dhe përmirësimi i kapacitetit për modernizim. Ai ka treguar se ndër objektivat kryesore të ATK-së për këtë vit janë modernizimi i këtij institucioni përmes zëvendësimit të sistemit të teknologjisë informative, lansimi i faturës elektronike të TVSh-së (E-Invoicing), ngritja e kapaciteteve në fushën e menaxhimit të riskut si dhe zbatimi i reformës 2019-2021 për modernizimin e ATK-së

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 7 JANAR - Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Sakip Imeri, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se për këtë institucion sfida për vitin 2019 mbetet zbatimi i strategjisë së rrezikut institucional si dhe përmirësimi i kapacitetit për modernizim. "Sfidë mbetet zbatimi i strategjisë së rrezikut institucional, si dhe përmirësimi i

kapacitetit për modernizim", ka ka bërë me dije Imeri.

Ai ka folur edhe për planet e ATK-së për këtë vit. "Planet për vitin 2019 janë implementimi i strategjisë së ATK-së 2015-2020, përmbushja e objektivave të parapara me planin vjetor të punës, përmbushja e objektivave në kuadër të MSA-së, zbatimi i strategjisë për parandalimin dhe luftën kundër ekonomisë joformale, modernizimi i ATK-së përmes zëvendësimit të sistemit të teknologjisë informative, lan-

simi i faturës elektronike të TVSh-së (E-Invoicing), ngritja e kapaciteteve në fushën e menaxhimit të riskut si dhe zbatimi i reformës 2019-2021 për modernizimin e ATK-së", është shprehur Imeri.

Ndërkaq sa i përket vitit që lamë pas, Imeri ka deklaruar se institucioni të cilin ai e udhëheq ka tejkaluar të hyrat për më shumë se 10 milionë euro. "Administrata Tatimore e Kosovës gjatë vitit 2018 ka tejkaluar të hyrat e planifikuara

strategjisë së rrezikut institucional

tatimpagueseve, të cilët do ta kenë më të lehtë informimin dhe kryerjen e obligimeve në mënyrë vullnetare", ka thënë Imeri.

Po në këtë bisedë ka folur edhe për aktivitetet të cilat e kanë karakterizuar ATK-në gjatë vitit 2018. "Viti 2018 për ATK-në ka qenë i mbushur me aktivitete në të gjitha fushat ku ka përgjegjësi ligjore në administrimin e tatimeve, ngritje dhe avancim të përmbushjes vullnetare të tatimeve, shërbime profesionale, transparente dhe efektive, zhvillim të aplikacioneve për menaxhimin e proceseve tatimore, avancim të analizës së riskut për përzgjedhjen e rasteve për kontroll të tatimpaguesve, ngritje të efikasitetit [ër trajtimin e kërkesave për rimbursimin e tatimeve, strukturim të tatimpaguesve sipas fuqisë ekonomike që zotërojnë, sistemim të zyrtarëve tatimorë në funksion të ngritjes së kompetencës profesionale dhe përgjegjësisë në punë, komunikim të shtuar me tatimpagues dhe bashkëpunim i shtuar ndërinstytucional në luftimin e dukurive negative dhe ekonomisë joformale, me policinë, doganën, prokurorinë, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve TI (ARBK), komunat etj", ka thënë Imeri, i cili ka folur edhe për bashkëpunimin e ATK-së me donatorët ndërkombëtarë dhe kontributin e tyre në fushën tatimore. "Gjithashtu, kemi pasur mbështetje të fuqishme nga donatorët, FMN, GIZ, KE, USAID, BB, Ambasada Britanike etj. Me përkrahjen e tyre janë realizuar studime dhe raporte që e ndihmojnë ATK-në në zhvillimin e saj: FMN ka realizuar disa misione të shoqëruara me raporte specifike për proceset tatimore, është realizuar TADAT një vlerësim diagnostikues për nënte fusha specifike të vlerë-

suara sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe raporte të tjera për modernizimin e mëtutjeshëm të funksioneve të ATK-së", u shpreh Imeri.

Ai ka përmendur edhe kontributin e donatorëve për zhvillimin e sistemit tatimor në Kosovë. "GIZ-i ofron mbështetje për zhvillimin e funksionit ZgjoNA, kontrollet tatimore elektronike, është realizuar anketa për kënaqshmërinë e TP dhe në bashkëpunim me Bankën Botërore është realizuar projekti i ngritjes së përmbushjes tatimore përmes qasjes

bihevoriste, një projekt unik i realizuar për herë të parë në vendet e Evropës juglindore dhe më gjerë. USAID-i ka mbështetur zhvillimin e procesit të rimbursimit tatimor përmes menaxhimit elektronik dhe të indikatorëve 'Pagesa e tatimeve' përmes të cilave bëhet edhe vlerësimi në raportin e BB 'Doing business', në të cilin Kosova radhitet në pozitën e 44-t në mesin e 192 vendeve në botë", ka deklaruar Imeri. Ai ka shtuar se me Ambasadën e Britanisë së madhe dhe GIZ-in kanë nënshkruar një marrëveshje

për mbështetjen e ATK-së për fuqizimin e kapaciteteve profesionale për raportim financiar dhe tatimor si dhe për ngritjen e transparencës përmes medieve të aktiviteteve operative të ATK-së. "Gjithashtu, janë realizuar aktivitete në bashkëpunim me administratat tatimore rajonale dhe kemi qenë pjesëmarrës në konferenca ndërkombëtare në të cilat ka vlerësime pozitive për zhvillimin e ATK-së", ka deklaruar Sakip Imeri, drejtor i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës.

Efeki i taksës: Kosova importoi 10 milionë kilogramë grurë më pak nga Serbia

PRISHTINË, 7 JANAR - Vetëm në muajin e parë të taksës, 10 milionë kilogramë grurë më pak kanë hyrë nga Serbia krahasuar me të njëjtën periudhë në pesë vjetët e fundit, kanë pohuar zyrtarë të Doganës së Kosovës. Vetëm gjatë muajit të parë të implementimit të taksës Kosova ka importuar nga Serbia rreth 120 milionë kilogramë grurë, nga 130-140 milionë sa ka importuar për periudhën e njëjtë kohore në vitet e fundit.

Zëdhënësi i Doganës, Adriatik Stavileci, ka bërë me dije për "KosovaPress" se deri në vendosjen e taksës importimi i grurit ishte në të njëjtin trend me vitet e kaluara. "Edhe ky vit, deri kur është aplikuar masa mbrojtëse, ka qenë me të njëjtin trend, por prej nëntorit ky trend ka rënë dhe tani kemi 120 milionë kilogramë



grurë të importuar. Në aspektin e origjinës, e kemi vërejtur se 90 për qind e këtij gruri është me origjinë nga Serbia,

por pas aplikimit të masës tani origjina ka filluar të ndryshojë, pra të vijë edhe prej vendeve të tjera", u shpreh Stavileci.

OAK-u: Të lirohet lënda e parë për prodhuesit

PRISHTINË, 7 JANAR (ER) - Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) ka kërkuar nga ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, dhe ministri i Financave, Bedri Hamza, që ta lirojnë lëndën e parë për prodhuesit vendorë ashtu siç është e paraparë me ligj. Sipas OAK-ut, arsyeja e kërkesës është ankesa e prodhuesve lidhur me lirimin nga TVSh-ja e lëndës së parë. "Çdo fillim të vitit prodhuesit vendorë obligohen të aplikojnë në ATK për lirim nga TVSh-ja për lëndën e parë të importuar, ndërsa pas aprovimit të saj fillon edhe zbatimi në Dogana. Vitet paraprake shqyrtimi i kërkesave është bërë për një periudhë më të shkurtër kohore,

që nuk i ka penguar bizneset në vazhdim të prodhimit", është thënë në njoftimin e kësaj ode. OAK-u ka bërë me dije se këtë vit bizneset po përballen me probleme pasi për shkak të mosshqyrtimit të këtyre kërkesave lënda e parë ka mbetur pa kaluar në Doganë dhe, si pasojë, bizneset po detyrohen të paguajnë për qëndrimin e kamionëve dhe frigoriferëve në terminale, si dhe po krijojnë edhe pengesa në prodhim. "Oda e Afarizmit të Kosovës kërkon që të merren masat e nevojshme për këtë problem. Oda e Afarizmit të Kosovës kërkon që të përkrahen prodhuesit vendorë, duke u lejuar ta bëjnë futjen e lëndës së



parë në Doganë derisa të shqyrtohen aplikacionet nga ATK-ja. Gjithashtu, OAK kërkon që kjo procedurë të hiqet ashtu që të mos obligohen bizneset të

aplikojnë çdo vit", është theksuar në njoftimin e OAK-ut. Kjo kërkesë i është drejtuar edhe kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj.

me shumë se 10 milionë euro. Nga 446 milionë euro janë mbledhur 456 milionë euro që në raport me vitin 2017 janë për 41,6 milionë euro më shumë. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë arkëtuar mbi 150 milionë euro të hyra nga Kontributet Pensionale për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK). ATK-ja vazhdimisht është duke zhvilluar aktivitete për ta ngritur nivelin e përmbushjes së obligimeve tatimore, përfshirë transparencën në shërbimet ndaj

Komuna e Prishtinës pastron nga bora rrugët kryesore

PRISHTINË, 7 JANAR (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se ka bërë pastrimin e të gjitha rrugëve kryesore në kryeqytet pas reshjeve të fundit të borës. Kjo komunë u ka bërë thirrje drejtuesve të automjeteve që të kenë kujdes gjatë vozitjes. "Pas reshjeve të borës gjatë ditës së djeshme, mbrëmë ekipet kanë punuar në orët e vona deri në mëngjes për t'i pastru-

ar rrugët kryesore të kryeqytetit për ta vazhduar punën sot në rrugët dytësore. Për çdo urgjencë lajmëroni qendrën e thirrjeve në 038 245 777. Ju lusim për qarkullim të kufizuar, përshtatje të shpejtësisë dhe përdorim të pajisjeve dimërore gjatë reshjeve dhe temperaturave të ulëta", ka njoftuar Komuna e Prishtinës e cila udhëhiqet nga Shpend Ahmeti.



Jashari kërkon nga qytetarët e Skenderajt të jenë të kujdesshëm në komunikacion

SKENDERAJ, 7 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se pas reshjeve të borës kanë shtuar angazhimin e kompanive kontraktuese për pastrimin e të gjitha rrugëve në territorin e kësaj komune. Ai ka thënë se ky angazhim

nuk do të ndalet derisa të pastrohen të gjitha rrugët në Skenderaj. "Pas reshjeve të borës në mbrëmje kemi shtuar angazhimin që nëpërmjet kompanive të kontraktuara të pastrohen rrugët nga bora dhe ngricat eventuale në mënyrë që qarkullimi të bëhet me

lehtësi. Makinaria e kompanive nuk do të ndalet dhe do të vijojë punën rreth pastrimit të secilës rrugë e në çdo fshat. Krahas punës në terren, lus qytetarët të jenë shumë të kujdesshëm në komunikacion", ka thënë Jashari.

LV-ja kritikon Komunën e Prishtinës për mosrregullimin e shkallëve në lagjen 'Arbëria'

PRISHTINË, 7 JANAR (ER) - Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë ka kritikuar qeverisjen e Shpend Ahmetit për mosrregullimin e shkallëve në lagjen "Arbëria" në kryeqytet. "Ishin premtuar 120 ditë punë për rregullimin e shkallëve të 'Arbërisë' nga ana e Komunës së Prishtinës që nga marsi i vitit 2018 kur kanë filluar punimet. Por edhe tash që jemi në janar të vitit 2019 shkallët ende nuk kanë përfunduar. Pra, më shumë se gjashtë muaj vonesë. Shkallët e 'Arbërisë' janë arterie e rëndësishme për qarkullim të lagjes dhe për lidhjen e saj me qendrën e qytetit, veçanërisht kur dihet se ato shërbejnë si vazhdimësi e rrugës 'UÇK', duke e lidhur parkun 'Arbëria'



me Sheshin 'Adem Jashari'. Në vitin 2018 Komuna e Prishtinës kishte premtuar fil-

limin e shumë projekteve në qytet, përfshirë ndërtimin e katër parqeve të reja. Shkallët

e Arbërisë janë një nga projektet e rralla kapitale të filluara në fillim të vitit, por që po

vonohen për shkak të neglizhimeve nga administrata e komunës", është thënë në reagimin e Vetëvendosjes. Lëvizja Vetëvendosje ka ftuar ekzekutivin e Komunës së Prishtinës që sa më parë të nisnin projektet që janë me rëndësi për qytetin dhe të mos i zvarrisin ato pak punë që mezi kanë arritur t'i fillojnë. "Komuna e Prishtinës po përkeqësohet përditë duke pasur probleme me furnizim me ujë, probleme me parkingje, me trotuare të zaptuara, me mungesë rrugësh, ndotje enorme të ajrit, me trafik të rënduar, pa zgjidhje për trafikun urban dhe shumë probleme të tjera që po mblihdhen përditë", është thënë në këtë reagim.

Ramosaj: Investimet në Deçan do t'u japin shpresë deçanasve

DEÇAN, 7 JANAR - Ta qeverisë Komunën e Deçanit, për kryetarin Bashkim Ramosaj është sfidë dhe privilegj. Ai për "Kosovapress" ka folur për arritjet dhe problemet që ka hasur gjatë punës së qeverisjes së tij lokale, gjatë së cilës prioritete absolute kanë qenë arsimit dhe shëndetësia. Sipas tij, tashmë nxënësit dhe personeli arsi-

mor shumë më lehtë do ta kenë procesin mësimor, pasi tetëmbëdhjetë shkolla i kanë hyrë procesit të rinovimit të plotë. Të njëjtin efikasitet, ka thënë Ramosaj, ka pasur edhe në sektorin e shëndetësisë ku, sipas tij, shumë shpejt pritet që QKMF-ja në Deçan të jetë e kompletuar. Kryetari Ramosaj ka bërë me dije se dy projektet që janë vitale për Komunën e

Deçanit kanë filluar. Rruga Deçan - Plavë dhe rregullimi i shtratit të lumit në këtë qytet, sipas tij, do t'u japin shpresë qytetarëve të jetojnë në këtë qytet. Ndërsa për disa projekte që nuk janë realizuar këtë vit, kryetari Ramosaj ka thënë se do të realizohen vitin e ardhshëm. Të rëndësishme së veçantë ai ka përmendur zgjidhjen e problemit të ujit të pijshëm

në disa zona të Deçanit dhe zgjerimin e rrugës së qendrës në këtë komunë. Duke marrë parasysh se Deçani përbëhet prej shumë fshatrave dhe rol të rëndësishëm për zhvillim ekonomik dhe rritje të ardhurave të banorëve është bujqësia, kryetari Ramosaj ka thënë se ka bërë çmos që t'u dalë në ndihmë atyre përmes subvencioneve.



Narkoza e vizave - mit apo realitet (11)



Shkruan: Agron HOTI

Pastrimi i Kosovës

Nëse qëllimi i bashkësisë ndërkombëtare dhe specifikisht i BE-së ka qenë pastrimi i Kosovës nga gjoja krimet e luftës të kryerja nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila për hir të vërtetës u mbështet fuqishëm nga NATO dhe pothuaj nga tërë diplomacia botërore, atëherë pse nuk u hetuan edhe rastet e privatizimit që u udhëhoqën nga UNMIK-u?

Pra, e keqja është se nuk ndodhi as njëra e as tjetra. E ç'faj kanë qytetarët e Kosovës pse kjo nuk ndodhi?! Pse vazhdimisht u kalkulua politikisht?! Nëse drejtësia është e sinqertë, pa marrë parasysh a është vendore apo ndërkombëtare, ajo vetëm politikisht nuk duhet të kalkulojë, sepse po ndodhi ashtu, atëherë dihet se si mund të duket një sistem i drejtësisë?!

Sikur EULEX-i ta merrte me sinqeritet (qysh prej fillimit të misionit) si hetimin e gjoja krimeve të luftës ashtu edhe hetimin e privatizimit ku ishin të përfshirë vetë zyrtarë të ndryshëm të vendeve të BE-së, atëherë me siguri se gjendja e sundimit të ligjit sot do të ishte shumë më e mirë sesa që është. Pra, kush e ndali EULEX-in për një ndërmarrje të tillë, kur kishte të gjitha mjetet në dispozicion për të hetuar dhe arrestuar këdo në Kosovë?! Pse BE asnjëherë nuk reflekton për këtë dështim të vetin?!

Padyshim drejt BE-së Pa marrë parasysh çfarë ndodhi dhe u tha, Kosova kishte, ka dhe do të ketë vetëm një orientim, e ai është anëtarësimi i plotë në BE. Këtu nuk ka asnjë mëdyshje, ky orientim është i pa-alternativë. Sa më herët që ndodh kjo aq më mirë për BE-në dhe për Kosovën, natyrisht. BE-ja duhet të ketë parasysh se zgjidhjet e mëdha mund të dalin edhe përmes dyerve të vogla.

Në qoftë se qytetarët e Kosovës paska mundësi të shkojnë me kontrata pune nëpër të gjitha vendet e BE-së, pse nuk paskan mundësi që të shkojnë edhe për vizita turistike pa pasur nevojë të presin me orë të tëra dhe të paguajnë taksa të larta për viza?! Pse rinia jonë, aq e dëshiruar në tregun e BE-së (i

përballur me rënie të lirë demografike), qenka e mirëpritur për punë por jo edhe për vizita turistike?! A mund të konsiderohet kjo drejtësi?!

Qytetarët e Kosovës e vizitojnë kohë pas kohe Stambollin, i cili asnjëherë nuk ka vënë viza për Kosovën, por duke qenë të orientuar tërësisht kah BE duan që të frekuentojnë shumë më shpesh Berlinin, Parisin, Romën e Brukselin. Sepse orientimin pro-evropian qytetarët e Kosovës e tregojnë edhe në rrugë, ku mbi 95 % të makinave janë me prejardhje nga vendet e ndryshme të BE-së. Sepse orientimin evropian e tregojnë qytetarët e Kosovës edhe me flamuj të vendeve të ndryshme të BE-së të varur nëpër vende publike, shtëpi dhe çdokund. Përkundër vonesave të shumta që i shkakton rregullisht BE, nuk ka as edhe një vend në rajon që ka përqindje më të lartë pro integritimit evropian se sa Kosova dhe meriton të kihet parasysh.

A duhet pritur pa fund?!

Pra, edhe një herë, qytetarët e Kosovës nuk duhet ta paguajnë çmimin e pritjes pafund për viza, sepse nëse ka ndonjë shtet që ka paguar çmim më të madh për evropianizim të Evropës, atëherë qytetarët e Kosovës janë numër një në Evropë. Meqë vazhdimisht kemi kontribuar në të mirë të Evropës pse na duhet të paguajmë çmimin e pritjes së mëtejme për faktin e paqëndrueshëm të frikës në BE se liberalizimi i vizave mund të rrisë ndikimin e forcave ekstreme brenda Shteteve Anëtare të BE-së dhe mund të ndryshojë përbërjen e Parlamentit Evropian më 2019, forca këto të cilat janë të orientuara kundër emigracionit për efekte të pastra elektorale?! Vazhdimisht gjendet një arsytim për mosliberalizim, një herë thuhej plotësoni kriteret, kur ato u plotësuan, tash na dalin, edhe pse nuk thuhet publikisht, zgjedhjet për Parlament Evropian.

E kush garanton që pas zgjedhjeve të Parlamentit Evropian nuk do të ketë probleme të tjera. Vetë fakti që borxhi publik është në rritje në të gjitha vendet e BE-së tregon për krizën tjetër në ardhje brenda BE-së dhe më gjerë. Vetë kjo krizë financiare në ardhje mund të pjellë ndonjë -xit tjetër, pas Brexitit. E nëse BE gjendet në një situatë të tillë, atëherë duhet të jetë e sinqertë me vetveten në radhë të parë e pastaj edhe me qytetarët e Kosovës, duke u thënë që kemi mijëra probleme të brendshme

që janë duke e gërryer të ardhmen e BE-së. Demonstratat në Francë janë vetëm fillimi i thellimit të krizës brenda BE-së.

Konsensusi brenda BE-së ka qenë ndër pikat më të dobëta të BE-së, e kjo konfirmohet te mungesa e tij në politikën e jashtme, të sigurisë dhe të brendshme. Kjo sëmundje kronike e ka përcjellë BE-në që prej fillimit e deri më sot dhe problematika e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës veç sa e ka ri-konfirmuar mungesën e konsensusit brenda BE-së.

Argati dhe vetingu

Ky shkrim nuk është për t'i bërë argatin askujt, por vetëm flet për krahasime që mekin. Është fakt që Kosova ka korrupsion ashtu siç kanë të gjitha vendet e rajonit dhe BE-së. Po kjo nuk është ndryshe në asnjë vend të botës. Është fakt që sistemi i drejtësisë ka probleme strukturore. Por, nuk duhet harruar se sistemi i drejtësisë do të përmirësohet krahas zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Askush mos të shpresojë që një veting do të mund ta përmirësonte dukshëm këtë sistem.

Fundja, vetingu në Kosovë a nuk u bë tërësisht nga bashkësia ndërkombëtare?! Nëse qenka bërë keq, atëherë pse paska ndodhur ashtu? Vetingu është një veprim minor krahasuar me problemet strukturore që ka sistemi i drejtësisë, rrënjët e të cilit shtrihen që nga sistemi i super korruptuar dhe tejpoltizuar jugosllav, ku shqiptarët e Kosovës kurrë nuk i besuan sis-

temit të drejtësisë dhe shtetit jugosllav, gjithmonë i panë si të huaja dhe kjo logjikë do të ndryshojë vetëm me kalimin e kohës dhe natyrisht me ndryshimin e shoqërisë.

Për më tepër, vendet komuniste vetëm sisteme të drejtësisë nuk kishin, kjo sepse sistemet e atëhershme ishin sisteme të direktivave politike shtetërore, ku shteti ndërhynte haptazi në gjykata, prokurori, burgje dhe në të gjitha sferat e jetës publike dhe private. Sigurisht që ka korrupsion dhe krim të organizuar gjithandej, por çdokush që shpreson që sistemi i drejtësisë në Kosovë do të rregullohet për një kohë të shkurtë, atëherë ai apo ajo e ka humbur orientimin në kohë dhe hapësirë. Natyrisht që institucionet e Kosovës nuk duhet të ndalen në këtë drejtim, sepse përmirësimi i sistemit të drejtësisë është para se gjithash interes jetik për të ardhmen e qytetarëve të Kosovës. Por, dëshira me realitetin jo gjithmonë korrespondojnë.

Ligje pa ligje

Edhe në fushën e hartimit të legjislacionit të Kosovës dhe përafrimit të tij me atë të BE-së sa i përket Sundimit të Ligjit, vlen të theksohet se pothuaj të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore, përfshirë sistemin e drejtësisë janë hartuar me ndihmën e ekspertëve të BE-së. Edhe Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale së bashku me tërë legjislacionin penal dhe atë civil janë hartuar me ndihmën e ekspertëve të BE-së. Prandaj, nuk është e udhës që Kodi Penal dhe ai i Procedurës

Penale të plotësohen e ndryshohen shpesh sepse kjo krijon pasiguri dhe paqartësi ligjore, pasojat e të cilës do t'i bartin vetëm qytetarët e Kosovës. Ne e kuptojmë se vetë shoqëria është evoluive dhe konform saj hartohen politikat dhe legjislacioni, por nuk mund ta kuptojmë kur na thuhet se ky apo ai ligj nuk i plotëson të gjitha kriteret ndërkombëtare e ndërkohë që vetë ai ligj është hartuar nga projekte të BE-së.

Kjo ndodh shpesh nga ekspertët të BE-së, që për hir të vërtetës vijnë nga sfonte të ndryshme ligjore nacionale dhe kjo nganjëherë shkakton konfuzion mes institucioneve tona se cilat praktika t'i absorbojnë. Pra, sigurisht se ligjet duhet të përafrohen me legjislacionin e BE-së, por ato nuk bën të ndryshohen shpesh, sepse atëherë jostabiliteti ligjor është i pashmangshëm ashtu siç do të jetë e pashmangshme joefiçenca e sistemit të drejtësisë. E procesi i liberalizimit të vizave është hapi i dytë (dhe ndër më kryesorët) i BE-së pas MSA-së, kuptohet para anëtarësimit në këtë organizëm rajonal, që konfirmon dhe mban gjallë perspektivën evropiane për qytetarët e Kosovës. Prandaj, BE-ja duhet t'i hapë portat, sepse qytetarët e Kosovës qysh moti e meritonjë një trajtim të tillë. Nuk duhet harruar fakti që siguria individuale në Kosovë është shumë më e lartë se sa në metropolet e BE-së, për këtë ka fakte, por edhe vetë përfaqësues të vendeve të BE-së që veprojnë në Kosovë e thonë këtë. (Vijon)

The Schengen
Visa Countries



Marrëveshja për Brexit votohet më 15 janar

LONDËR, 7 JANAR - Ligjvënësit britanikë do ta votojnë planin për daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian, apo Brexit, më 15 janar, konfirmuan për BBC-në burime të Qeverisë në Londër. Votimi në Parlament është anuluar muajin e kaluar nga vetë kryeministria britanike Theresa May, e cila ka pranuar se plani i saj nuk ka mbështetje. BBC raporton se qeveria po përgatit siguri shtesë rreth

marrëveshjes. May ka arritur marrëveshjen për Brexitin me Bashkimin Evropian në muajin nëntor. Marrëveshja kundërshtohet edhe nga deputetë të partisë së saj, edhe nga ata të opozitës, të cilët thonë se ajo nuk e mbron mjaftueshëm Britaninë ose ruan lidhje tepër të afërta me BE-në. Presidenti i Komisionit të BE-së, Jean-Claude Juncker, do të zhvillojë bisedime me kryeministren

May këtë javë, por ai e përjashtoi mundësinë për rinegociimin e marrëveshjes, në mënyrë që ajo të fitojë mbështetje në Parlamentin britanik. Zëdhënësi i Komisionit Evropian, Margaritis Schinas, tha të hënën se marrëveshja në tryezë është më e mira dhe e vetmja e mundshme. Britania duhet të largohet nga BE-ja më 29 mars të këtij viti, pavarësisht nëse marrëveshja do të miratohet nga deputetët ose jo.



ShBA-ja synon marrëveshjen me Turqinë para tërheqjes nga Siria

Këshilltari i Sigurisë Kombëtare i ShBA-së, John Bolton, shkoi në Turqi në kërkim të një marrëveshjeje për kurdët që udhëhoqën një ofensivë të suksesshme të mbështetur nga Shtetet e Bashkuara kundër Shtetit Islamik në Siri



WASHINGTON, 7 JANAR - Këshilltari i Sigurisë Kombëtare i ShBA-së, John Bolton, tha se trupat amerikane nuk do të tërhiqen nga Siria pa arritjen e një marrëveshjeje me Turqinë për të mos sulmuar kurdët në Sirinë Veriore. Deklarata e presidentit amerikan Donald Trump më 19 dhjetor, për një tërheqje të menjëhershme, shkaktoi frikë mes kurdëve në Siri, të mbështetur nga Shtetet e Bashkuara. Turqia ka njoftuar planet për t'i sulmuar zonat e kontrolluara nga kurdët në Sirinë veriore duke pretenduar se kryengritësit e kësaj zone janë aleatë të një grupi terrorist kurd. Bolton shkoi në Turqi në kërkim të një marrëveshjeje për kurdët që udhëhoqën një ofensivë të

suksesshme të mbështetur nga Shtetet e Bashkuara kundër Shtetit Islamik në Siri. Plani për tërheqjen e 2000 trupave amerikane nga Siria ka ngritur shqetësimet se palët e tjera në konflikt mund ta mbushin boshllëkun. Turqia ka njoftuar një ofensivë ndaj kurdëve dhe Rusia dyshohet se po planifikon të hyjë në zonën e pasur me naftë sapo amerikanët të largohen. Izraeli ka paralajmëruar për ndërhyrjen e Iranit. Ka pasur edhe paralajmërimet se Shteti Islamik mund të nisë një përpjekje për ta rimarrë territorin që kishte humbur. Që atëherë, presidenti Trump ka thënë se tërheqja do të marrë kohë. "Ne po tërhiqemi nga Siria, do t'i tërheqim trupat tona,

nuk kam thënë kurrë se po e bëjmë këtë shpejt. Por ne po e shkatërrojmë ISIS-in", tha ai. Presidenti Trump dërgoi këshilltarin e tij të sigurisë kombëtare në Lindjen e Mesme për ta diskutuar tërheqjen me aleatët rajonalë, Turqinë dhe Izraelin. "Në kufirin tuaj kemi problemin e konfliktit në Siri. Ne do të diskutojmë për vendimin e presidentit për t'u tërhequr, por për

ta bërë këtë në një mënyrë që garanton se ISIS-i është mposhtur dhe nuk do ta ketë aftësinë për t'u rikthyer dhe për t'u bërë kërcënim përsëri. Ne gjithashtu duam të sigurohemi që të mos kërcënohet mbrojtja e Izraelit dhe miqve tanë të tjerë në rajon që kanë luftuar me ne kundër ISIS-it dhe grupeve të tjera terroriste", tha John Bolton, Këshilltar i Sigurisë Kombëtare.

Kurdët ishin në ballë të ofensivës në terren kundër Shtetit Islamik në Irak dhe në Siri. Tërheqja e ShBA-së i bënë ata të pambrojtur ndaj sulmeve nga forcat e Qeverisë siriane dhe nga Ushtria e Turqisë. Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka rënë dakord të shtyjë, por jo të anulojë një ofensivë, që ai thotë se ka për qëllim eliminimin e terroristëve nga Siria Veriore. "Biseda telefonike me Trumpin, kontaktet diplomatike, ato mes njërive të sigurisë dhe njoftimet e bëra nga amerikanët bënë që ne të presim edhe për ca kohë, por kjo nuk do të jetë një periudhë e pafund pritjeje", tha ai. John Bolton tha se tërheqja e ShBA-së nuk do të ndodhë pa një marrëveshje me Turqinë për mosvrastjen e kurdëve. Ai gjithashtu u bëri thirrje kurdëve të jenë të vendosur dhe të përmbahen nga kërkimi i një marrëveshjeje me Qeverinë siriane, presidenti i së cilës, Bashar al-Assad, duket se po rifiton legjitimitetin nga udhëheqësit e tjerë arabë.

Sulmohet Ambasada e ShBA-së në Athinë



ATHINË, 7 JANAR - Dy anarkistë grekë janë arrestuar të hënën, pasi lyen me bojë të kuqe Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Athinë. Tetë pjesëtarë të tjerë të organizatës anarkiste "Rubicon" u ndaluan po ashtu, por më pas u lanë të lirë, në lidhje me incidentin që, sipas policisë, ka shkakuar dëme minimale materiale. Ministria e Jashtme greke e dënoi sulmin, duke thënë se ai cenon marrëdhëniet e hershme miqësore mes dy vendeve dhe lidhjet

strategjike mes Greqisë dhe Shteteve të Bashkuara, që janë jetësore për vendin dhe rajonin. Grupi "Rubicon" i konsideron ndërhyrjet e Uashingtonit në një numër rajonesh, përfshirë edhe Ballkanin, si imperializëm. Anëtarët e tij ishin mbledhur para Ambasadës në orët e para të ditës dhe kishin lyer me bojë hyrjen, para se policia të ndërhynte. "Rubicon" ka kryer një numër aktesh të ngjashme mbi ambasadë, banka dhe godina publike vitet e fundit, duke shkakuar

dëme materiale, por jo lëndime. Tetorin e shkuar, grupi leu me bojë fasadën e Ambasadës së Kanadasë, në shenjë proteste ndaj pranisë së një kompanie minerare kanadeze që kërkonte ar në Greqinë Veriore. Më herë, "Rubicon" kishte vënë në shënjestër Ambasadën e Iranit, në shenjë solidariteti me kurdët e Iranit. Mediet greke raportojnë se grupi planifikon t'iu bashkohet, më 17 janar, një numri organizatash të tjera anarkiste në një tubim në Romë.

Parandalohet grushtshteti në Gabon

LIBREVILLE, 7 JANAR - Situata politike në Gabon është nën kontroll pas përpjekjes për grushtshtet, tha një zëdhënësi i qeverisë. Të pesë ushtarët rebelë, të cilët u përpoqën t'i marrin përgjegjësitë, u arrestuan nga

autoritetet. Në një video që qarkulloi në mediet sociale, tre ushtarë të rinj u panë të armatosur në një studio radioje, duke iu bërë thirrje njerëzve të ngrihen. Ata thanë se morën pushtetin për ta rivendosur demokracinë

në Gabon - vend i pasur me naftë - ku familja e presidentit Ali Bongo ka qeverisur për 50 vjet. Tanke dhe automjete të blinduara mund të shiheshin në kryeqytetin Libreville. Një nga rebelët ishte në arrati për një periudhë

të shkurtër, por është gjetur, raportoi Radio France Internationale. "Situata është e qetë. Xhandarët kanë marrë kontrollin e gjithë zonës përreth selive të radios dhe televizionit, andaj gjithçka i është rikthyer



normalitetit", tha zëdhënësi i Qeverisë, Guy-Bertrand Mapangou.

Dhuna seksuale nga forcat ushtarake serbe ndaj grave shqiptare gjatë luftës në Kosovë (2)

Aplikimi i gjenocidit biologjik si mjet lufte nga forcat serbe në Kosovë



Elife LUZHA

- Pushtimi i Kosovës dhe represioni serb mbi shqiptarët etnikë

Në vitin 1998 gjashtë policë për tri ditë me radhë kanë dhunuar Vjollcën. Më pas e kanë futur në një kamion me kufoma, ku ka përjetuar tmerrin e vërtetë. "Kisha dërguar djalin në spital, pasi ishte i paralizuar. I gjithë vendi ka qenë me policë. Atë ditë më morën burrin dhe e vranë. Mbeta me fëmijët. Hyra në shtëpinë e dajës së burrit për të shpëtuar. Por edhe aty hynë policë. Dhe të gjithë i qitën jashtë shtëpisë. Vetëm mua më mbajtën brenda. Më kanë dhunuar gjashtë policë, për tri ditë rresht".

Anëtarët e familjes kishin menduar se Vjollcën e kishin vranë policët serbë. Kur të afërmit e takuan pas disa ditësh, u gëzuan, sidomos fëmijët. Por ngjarja nuk përfundoi aty. "Pas disa muajsh kuptova se isha shtatzënë. Nëna më dërgoi te mjeku, që ta heq fëmijën. Prej asaj kohe nuk isha mirë. Në vitin 2000 më sollën trupin e burrit nga varreza masive. Më ftuan në morg që të identifikoja burrin dhe aty kam pësuar shumë trauma, sepse të gjitha kufomat më dukeshin të njëjta. Të gjithë meshkuj civilë të vranë gjatë luftës në Kosovë. (<https://drenicapress.info>)

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut në nenin 5 të saj thotë: "Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, veprimi ose dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar". "Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve e trajtimeve çnjerëzore ose degraduese", thuhet edhe në nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Por, përkundër këtyre të drejtave, që bota i krijoi për të mirën e njerëzimit, gjatë më se njëqind viteve të pushtimit serb në Kosovë, këto të drejta janë shkelur dhe janë përmbysur tërësisht. Ndaj me të drejtë shkrimtari ynë Ismail Kadare thotë se "marrëzitet serbe i kanë kaluar veprimet e nazistëve në gadishullin e Ballkanit".

Krahas dhunës sistematike

kundër popullsisë civile në Kosovë, barbaria serbe "aplikoi edhe formën e gjenocidit biologjik, "që është më i fshehtë dhe nuk manifestohet me viktima të mëdha", thotë politologu Bardhyl Mahmuti (Mahmuti, 2015:291). Gjatë luftës në Kosovë u dhunuar mbi 20000 gra dhe vajza shqiptare, "me qëllim që të goditet gruaja, simboli i vazhdimësisë biologjike të grupit. Këto akte kishin për qëllim të goditej gruaja si nënë e ardhshme, qoftë për të cenuar integritetin e saj fizik dhe moral, qoftë për ta penguar të krijojë vazhdimësinë e grupit" (Mahmuti, 2015:293).

Sipas Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, cenimi i integritetit fizik dhe mental të anëtarëve të grupit nacional, etnik, racor apo religjioz përbën akt gjenocidi. "Sot askush nuk mund ta kontestojë faktin, se dhunimi dhe dhuna seksuale mbi gruan përbën cenim të rëndë të integritetit fizik apo mental të saj. Dhunimet seksuale në Bosnjë, Kroaci dhe Kosovë u bënë mjet bashkëkohor i luftës dhe synonin shkaktimin e dëmeve të pariparueshme ndaj anëtarëve të grupit" (Mahmuti, 2015: 292). "Pra, dhunimi dhe dhuna seksuale përbëjnë shkelje të konventës së lartpërmendur, sepse dhunimi i shkakton viktimit trauma dhe plagë të pashlyera psikologjike" (po aty).

Edhe Organizata e Kombeve të

Bashkuara ka bërë të ditur se në Ballkan (Kosovë, Kroaci e Bosnjë) janë dhunuar seksualisht 60 000 femra. "Megjithatë, kjo organizatë më 1992, pas një presioni publik për përdhunimet në ish-Jugosllavi, bëri që në vitin 2008, Këshilli i Sigurimit të miratojë Rezolutën 1820, e cila përdhunimet dhe format e tjera të dhunës seksuale i njohu si krime lufte dhe krime kundër njerëzimit" (<https://www.koha.net/>).

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë 1820 (2008) pranon se dhuna seksuale është përdorur si taktikë lufte për të poshtëruar, dominuar, frikësuar ose zhvendosur me forcë anëtarët civilë të një komuniteti apo grupi etnik. Ajo kërkon nga vendet anëtare, që përdoruesit e dhunës seksuale t'i ndjekin penalisht dhe të gjitha viktimat, sidomos gratë dhe vajzat, të kenë mbrojtje të barabartë në drejtësi. Rezoluta kërkon gjithashtu, që t'i jepet fund mosdëshkimin për dhunë seksuale. "Organizata për të Drejtat e Njeriut Amnesty International, dhunën seksuale lidhur me konfliktin e përkufizon si dhunë kundër grave, burrave, vajzave dhe djemve, që ndodh në rrethana konflikti ose paskonflikti dhe që ka lidhje të drejtpërdrejtë me vetë konfliktin" (www.amnesty.org/).

Siç bënte ditur kjo organizatë, në Kosovën e viteve 1998-99, gjatë fushatës së prindjekjes dhe

dhunës kundër shqiptarëve nga forcat ushtarake e policore serbe, në mënyrë sistematike janë përdhunuar mijëra gra. Në raportin me titull "Plagët që djegin shpirtat tanë" shpalosen pasojat shkatërruese fizike dhe psikologjike të dhunës seksuale të provuara nga të mbijetuarat. "Gratë dhe vajzat shqiptare iu nënshtroan përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës, që përbëjnë torturë. Shumë të mbijetuara i njohin dhunuesit e tyre edhe me emër. Megjithatë, deri tani vetëm 4 udhëheqës ushtarakë dhe politikë serbë janë dënuar për dhunë seksuale, si një krim kundër njerëzimit në Gjykatën Ndërkombëtare për Krime Lufte në ish-Jugosllavi" (www.amnesty.org). "Nuk kemi asnjë shpresë në drejtësi", thotë një e mbijetuar e dhunës. "Unë isha 30 vjeçe kur u ushtroa dhunë mbi mua dhe tani gati mbush të 50-at". Përdhunimi "është një plagë që ta djeg shpirtin ditë për ditë", e të bën të turpëroresh para familjes e komunitetit. Atë e mban me vete gjithë jetën (po aty). "Me një fjalë, pas aktit të dhunimit, në vend të ngushëllimit e të kujdesit, ato përjetonin një shkretëtim tjetër, të panjohur, të palogjikshme, sikur të kishin dalë në anën tjetër të pasqyrës, atje ku nuk ka më asgjë të kësaj bote" (Kadare, 2011: 10).

Duhet thënë se një ndër gratë e para që ka ngritur zërin për të dëshmuar për aktin e dhunës seksuale të ushtroar ndaj saj,

nga dy persona të maskuar, në shtëpinë e saj dhe para burrit dhe fëmijëve të saj, është Sevdie Ahmeti, bashkëthemeluesja e OJQ-së, Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve.

Kohët e fundit edhe znj. Vafije Krasniqi-Gudman, rrëfeu historinë e saj të dhimbjes, duke inkurajuar edhe gratë e tjera që të flasin për dhimbjen e tyre, për të mos jetuar në stigmë. Heshnja në lidhje me krimin dhe çfarëdo forme tjetër të dhunës, nuk çon kah shërimi i plagëve të të mbijetuarve e as të shoqërisë.

Ndryshimet ligjore më 2014, në Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, që njohu edhe statusin e viktimave, me mundësi kompensimi për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë kohës së luftës, si dhe hapjen e procesit të verifikimit për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, përbënë një pikë kthese në mbështetjen e të mbijetuarve. Por ndihma financiare e ofruar që nga 5 shkurti i vitit 2018, natyrisht nuk paraqet asgjë më shumë se vëmendje simbolike nga ana shtetërore, që në fakt edhe sipas ligjeve ndërkombëtare, vetëm përmbush detyrimet ndaj viktimave të luftës, që nuk do të guxonte të përfundonte me aq. Gjithsesi, të mbijetuarat e dhunës seksuale kanë nevojë për rehabilitim, kujdes shëndetësor dhe ndihmë psikologjike. Ato, më shumë se për çdo gjë tjetër, kanë nevojë për vëmendjen tonë. (Vijon)



E rrallë

S'ka më "divorce sekrete", femrat saudite do të njoftohen me SMS

Një legjislacion i ri në Arabinë Saudite pritet t'i japë fund praktikës së deritanishme të të mosnjoftuarit të femrave në raste divorci. Tani gjykatave do t'u kërkohet t'i njoftojnë femrat përmes një mesazhi SMS në telefonat celularë, mbi vendimet që konfirmojnë divorcet e



tyre. Avokatet lokale thonë se masa e re do t'u japë fund të ashtuquajturave "divorce sekrete", në të cilat meshkujt mund të zgjedhin t'i japin fund martesës së tyre pa ua thënë këtë bashkëshorteve.

BARSOLETA E DITËS



Baba: - A e ndreqe notën në matematikë, o djali jem?

Djali: - Jo babë, se profesori kudo që po shkon po e merr ditarin me vete.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



FOTO E DITES



Anëtarët e Shoqatës së Ruajtjes së Zjarrfikësve Edo në Tokio performojnë me rastin e Vitit të Ri 2019. /AFP/

Në ora 17:30 "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30 "MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00 "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

E jashtëzakonshme

Kina krijon yllin artificial, gjashtë herë më të nxehtë se dielli

Kina ka krijuar diellin artificial që është gjashtë herë më i nxehtë si dielli. Këtë shpikje ata e shohin si një burim të pastër energjie. Shkencëtarët pretendojnë se simulatori diellor, me bazë në tokë, ka arritur një temperaturë 100 milionë gradë celsius. Dielli ynë nxeh me një nxehtësi prej



15 milionë gradë celsius. Instituti "Plazma Physics", nga Akademia Kineze e Shkencave, e ka krijuar yllin artificial për të kuptuar se si shpërndahet energjia nga ylli që ndodhet në qendër të sistemit tonë.



DASHI

Këtë ditë do të keni logjikë të

ftohtë për marrjen e vendimeve, por do të jeni dhe mjaft të ndjeshëm karshi personave që ju duan.



DEMI

Javë e çuditshme që më

shumë do të merreni me udhëtime se me punën tuaj rutinë. Nuk jeni mësuar me këto ritme dhe dita sot do t'ju lodhë.



BINJAKËT

Sot do të jeni shumë korrekt me

takimet, gjë që nuk ndodh zakonisht me ju. Në mbrëmje do t'ju pëlqejë surpriza që ka përgatitur partneri.



GAFORRJA

Po mundoheni të

vendosni rregull në një vend që ka pllakosur kaosi. Nuk do t'ia dilni dot mbanë të vetëm, kështu që kërkoni ndihmë.



LUANI

Duket sikur nuk po ju

dëgjojnë dhe nuk po ju kuptojnë. Mbase është perceptimi juaj i gabuar sepse do të keni rezultate shumë të shpejta.



VIRGJËRËSHA

Mendime të kundërta ju

turbullojnë mendjen dhe nuk dini se nga të pozicionoheni. Është mirë ta dëgjoni zemrën ndonjëherë.



PESHORJA

Si në jetën në çift ashtu edhe

në familje, këtë periudhë do të dilni si persona që nuk kënaqen kurrë. Ju thjesht doni të jeni perfekt në detaje.



AKREPI

Intuita sot nuk do t'ju lërë në baltë.

Në shumë raste do të kishit gabuar, po sot do të jeni mjaft përpara vetëm falë intuitës që keni.



SHIGJETARI

Pak interes për të

komunikuar me njerëzit sot dhe dëshirë mjaft e madhe për të qenë më afër me natyrën.



BRICJAPI

Sot do ta nisni ditën me këmbën

e mbarë dhe po kështu do ta përfundoni. Duhet t'i falënderoni yjet që janë në anën tuaj këtë ditë.



UJORI

Megjithëse këtë periudhë jeni të mbin-

garkuar, do të gjeni pak kohë për të kaluar në shoqëri të mirë. Miqtë janë ata tek të cilët mbështeteni gjithmonë.



PESHQIT

Dashuria është ajo që ju

ndjek gjatë gjithë ditës së sotme. Por, jeni ju që po tregoheni pak indiferent në këto momente dhe nuk i kushtoni rëndësi.

Jamie Foxx flet për pushimet me Katie Holmes



Gjatë pushimeve Jamie Foxx dhe Katie Holmes u panë duke shijuar disa ditë romantike së bashku në zonën e Miamit. Pas pushimeve, Jamie dha një koment për herë të parë publikisht. Kur u pyet për pushimet, aktori 51-vjeçar ka thënë për "Us Weekly": "ishte i

pamend". Është e paqartë se çfarë deshi të thoshte Jamie me këtë deklaratë, pasi çifti u pa duke u puthur në një jaht. Jamie dhe Katie e kanë mbajtur shumë private lidhjen e tyre dhe ende nuk dihet kur kanë nisur të takohen edhe pse thuhet se marrëdhënia e tyre filloi në vitin 2013.

Beyonce paditet nga një grua e verbër për diskriminim



Një grua e verbër ka ngritur një padi kundër kompanisë së Beyonces, "Parkwood", duke pretenduar se faqja e internetit e këngëtares i diskriminon ata që janë të verbër. Mary Conner, i cili është

ligjërishi i verbër, ngriti padinë në një gjykatë. Faqja e internetit nuk lejon që fansat e verbër të blejnë bileta, të marrin më të rehat të turneut, të blejnë mallra ose të mësojnë më shumë për Beyoncen, sipas padisë që ka ngritur.



Kylie Jenner shfaqet me një unazë të madhe diamante

Kylie Jenner ka ngjallur thashetheme se ajo është fejuar me Travis Scottin pasi u pa një unazë e madhe diamanti në gishtin e saj. 21-vjeçarja tregoi unazën në disa

fotografi të postuara në "Instagram". Ajo nuk ka dashur ta zbulojë, por kjo nuk u ka ikur fansave të saj të cilët e kuptuan një ndryshim të mundshëm të Jennerit.

Deena Cortese bëhet nënë



Deena Cortese është bërë nënë. 31-vjeçarja dhe bashkëshorti i saj Chris Buckner kanë mirëpritur djalin e

tyre i cili quhet Christopher John. Të dy kanë postuar fotografi të foshnjës në rrjetin social "Instagram".

INTERVISTË ME AKADEMIK MEHMET KRAJËN (3)

LETËRSIA BRENDA VETES NUK I NJEH PËRKUFIZIMET TEORIKE



MEHMET KRAJA

dhe rrëfimit, çfarë faktesh të tjera e përbëjnë metafiksionin historiografik?

Lindita Aliu-Tahiri ka bërë studimin monografik "Monologu, personazhi, autori", pjesën më të madhe të të cilit ia kushton romanit tim "Im atë donte Adolfin". Natyrisht, unë jam mirënjohës për këtë, ndërsa menjëherë më duhet të them se studiuesja më ka habitur me depërtimet e thella, me erudicionin, diskursin inteligjent dhe me aplikimin e suksesshëm të dijeve të avancuara të studimeve letrare, veçmas të arealit gjuhësor anglo-amerikan. Prandaj studimi i saj monografik është i veçantë dhe nuk ndjek skemën e zakonshme të dijeve letrare të konsumuara jashtëzakonisht shumë të ne, të cilat duket sikur vendnumërojnë që gjysmë shekulli e këndeje por, në njëfarë mënyre, bën një bashkëkohësim dhe përaftrim të këtyre studimeve me një "krah" tjetër të tyre dhe me teorinë e komunikimit, si më të avancuarat që konsiderohen aktualisht. Tani të ndalemi pak te "metafiksioni historiografik" që u përmend këtu. Së pari duhet sqaruar se metafiksioni lidhet me prirjen dhe insistimin e autorit për t'ia bërë me dije recipientit se është duke lexuar një vepër imagjinare, në këtë rast një "konstruktion historiografik" imagjinar. Çka do të thotë kjo praktikisht në një vepër letrare? Se ngjarjet historike kanë variante dhe këndvështrimet të ndryshme dhe një nga këto është edhe këndvështrimi i shkrimtarit. Këtë interpretim të vepërve të mia letrare "Im atë donte Adolfin" dhe "Selvitë e Tivarit", po edhe "E zeza dhe e kuqja" e konsideroj si të mirëqenë sepse, nga njëra anë, këto "histori" të miat nuk mund të jenë gjë tjetër vetëm variante të një korpusi ngjarjesh, të cilat, për shkak të pjesëmarrjes së gjerë të njerëzve në to, kanë edhe dimension shumëplanësh, ndonjëherë krejt të kundërta. Dhe unë nuk dua t'ia fsheh lexuesit këtë fakt, madje ai do të duhej ta kuptonte se autori është duke i rrëfyer një ngjarje që mund të ishte fare lehtë imagjinatë e tij. Te romani "Im atë donte Adolfin" paraprakisht kam vënë dy teza (megjithatë, romani nuk është rrëfim me teze të paravendosur), se lufta ka anën e saj komike, varësisht nga vendi ku zhvillohet ajo dhe se çfarë synojnë personazhet; dhe, e dyta, ideologjitë e mëdha, siç janë fashizmi dhe komunizmi, në vende të vogla dhe te popujt e vegjël prodhojnë tragjedi të përmasave të mëdha. Te romani "E zeza dhe e kuqja" metafiksioni shkon një hap më tej: të rënët në ngjarje historike nuk i mbarojnë rrëfimet dhe bëmat e tyre në botën e të gjallëve, por historitë e tyre vazhdojnë edhe përtej, në botën e të vdekurve.

Metafiksionin e kam përdorur më shumë te romani i fundit "Prishtina". Te ky roman, paralelisht me rrafshin e ngjarjeve reale ose të atyre që i përngjasin realitetit, kam vendosur një sërë rrëfimesh, për të cilat e theksoj në rrëfim e sipër se janë të imagjinuara nga autori, kësh-tu që aty-këtu në këtë roman mund ta gjeni shprehjen "Duke qenë se jam shkrimtar, unë nuk e kisha të vështirë të merja me mend se çfarë ndodhi më pas..." ose diçka të ngjashme.

Dhe tani, çfarë përmban metafiksioni historiografik, pyetni ju, përveç kujtimit dhe rrëfimit? Unë asgjë nuk e ndaj dot nga rrëfimi sepse, sipas mendimit tim, çdo gjë në roman i referohet rrëfimit. Shpesh do të dëgjoni duke thënë se subjekti i romanit imponon rrëfimin e përshtatshëm etj. Unë mendoj të kundërtën: rrëfimi kërkon dhe gjen subjektin e përshtatshëm. Metafiksioni, ndërkaq, mendoj se është kategori që përfshin edhe subjektin, edhe rrëfimin, pra është një- lloj sinteze e dy komponentëve të brendshëm të romanit. Metafiksioni historiografik nuk besoj se mund të jetë gjë tjetër përveç rrëfim "historiografik" i përshtatshëm nga shkrimtari, i mbështetur mbi imagjinatën dhe të ashtuquajturën kujtesë kolektive. Pra, kujtesa kolektive është sfondi ku strukturohet rrëfimi. Po tjetër, pyesni ju. Çdo gjë, fate njerëzish, përjetime, gjendje reale dhe gjendje imagjinare, të gjitha këto të vendosura në një "realitet gjuhësor" rrëfyes, që është original dhe i papërsëritshëm. Në romanin "Prishtina" edhe diçka më shumë: observime dhe shqetësime filozofike, më shumë se në çdo roman të letërsisë shqipe.

Shkrimtarët tanë hiqen sikur janë shkrimtarët më të mëdhenj të botës

Edhe pse nuk e bëni më punën e redaktorit të medias, zhvillimet e letërsisë shqipe i përcillen. Çfarë po krijohet sot më shumë dhe çfarë do të duhej të krijohet?

Mediokriteti është armiku më i madh i çdo letërsie dhe në këtë kohë pikërisht promovimi dhe vlerësimi i vepërve mediokre zë vendin më të madh në jetën tonë kulturore dhe letrare. Natyrisht, rrënimin e sistemit të vlerave ka bërë që zhvillimet në letërsi të shkojnë në drejtim të gabuar në shumë raste. Unë nuk kam qenë asnjëherë ihtar i hierarkive as kombëtare, as shtetërore në letërsi dhe arte, sepse ato manipulojnë, por as kështu nuk bëhet, të mos kuptohet asgjë, të mos merret vesh asgjë, një "pluralizëm" kaotik, në të cilën më së miri gjenden ata që bëjnë letërsi të dobët, ata që dinë ta manipulojnë median ose auditorin. Në këtë rrethanë, letërsia mediokre është ajo që e dominon letërsinë tonë gjithandë dhe kjo situatë, si të thuash, është e mirëseardhur për një numër të madh shkrimtarësh të cilët kryesisht bëjnë letërsi të tillë, janë të vetëdijshëm për këtë, por jetojnë të kënaqur, duke abuzuar me paaftësinë e ambientit kulturor që t'ia dallojë vlerat nga jovlerat. Po e marrim një fushë që, mbase, pak njerëz e njohin si duhet, ku për një kohë më të gjatë dominuan

mediokrit dhe që, më në fund, arritën të shkatërronin çdo gjë, pra dramaturginë. Në Shqipëri nuk shkruhet drama si gjini letrare, nuk ka pasur ndonjë zhvillim as në kohën e komunizmit, kurse më pas pushoi së ekzistuari. Kjo ndodhi për shkak se diktatura ushtronte një kontroll të madh mbi teatrin. Në Kosovë situata ishte pak më ndryshe, sepse teatri, me të cilin lidhet drama, pat një zhvillim më normal. Çfarë ndodhi, ndërkohë? Teatrot morën tatëpjetën e pakthyeshme, drama gjithashtu. Në teatrot shqiptare, kudo që ishin, u bë një luftë pa kompromis kundër dramës origjinale. Në mënyrë institucionale dramës iu vërsulen ministritë, teatrot, fakultetet e arteve, aktorët, regjisorët dhe, natyrisht, dramaturgët e katedrave, të cilët deshën (si askush tjetër!) ta shpëputnin dramën nga letërsia dhe ta zhvendosnin në mediatiteti teatror, që në të vërtetë është improvizim i një lloji të veçantë. Këtë e bënë me sukses. Sot, çuditërisht, letërsia shqipe mund të jetë ndër letërsitë e pakta që nuk e kultivon dramën si gjini letrare. Kjo prodhoi dy situata paradoksale, antikulturore: drama shqipe nuk ekziston më, por më rënien e saj pësuan goditje edhe teatrot, të cilat kanë mbetur si rrënoja kulturore, që nuk i duhen më askujt. Ato tani i kanë marrë në dorë OJQ-të dhe, sa shoh, të gjithë janë të lumtur, sepse teatrot janë kthyer në çerdhe prostitucioni kulturor dhe kanë arritur t'i përjashtojnë shkrimtarët nga skenat e tyre. Kjo, si të thuash, është fitorja më e madhe (shkatërruese) institucionale mbi letërsinë, e cila nuk mbahet mend të ketë ndodhur ndonjëherë. Në të vërtetë, mua më vjen turp që jam bashkëkohës me këtë zhvillim kaq të shëmtoj në kulturën tonë dhe, pavarësisht se nuk kam asnjë mundësi të ushtroj ndikim, disi vetvetiu ndihem përgjegjës që, bashkë me komunitetin artistik dhe letrar, nuk mund të bëjmë asgjë për ta ndryshuar këtë gjendje. Tani t'ia kthehem pyetjes: Çfarë krijohet dhe çfarë duhet të krijohet? Unë jam shkrimtar, jam brenda letërsisë dhe nuk mund të jap udhëzime por, edhe sikur të jap, askujt nuk do t'ia hynin në punë. Di të them vetëm një gjë: duhet të bëhet më shumë letërsi e mirë, letërsi që shkruhet mirë, nuk ka rëndësi në këtë kohë, por, të paktën, në këtë kohë të kësaj proze, poezi, dramë, apo kritikë letrare. Të shkruarit keq është armiku më i madh i letërsisë, i të gjitha letërsive, prandaj edhe i letërsisë sonë. Dhe, si për inat, letërsi e dobët prodhohet aq shumë! Më pas vjen poza: shkrimtarët tanë hiqen sikur bëjnë mrekulli, sikur janë shkrimtarët më të mëdhenj të botës. Ç'është e vërtetë, në përgjithësi ne kemi letërsi të mirë dhe këtë e bëjnë një numër i kufizuar shkrimtarësh. Shumica nuk kanë përse mburren.

(Intervista është marrë nga numri i katërt i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia". Vijon në numrin e ardhshëm të gazetës. Intervistoi: B. Armagedoni)

Realizimin e kësaj interviste e vonova pak kohë sepse, ndër të tjera, i lexova edhe disa prej veprave tuaja që më kishin mbetur pa lexuar e që i kisha lënë në raftet e bibliotekës sime në banesë. Sa kam vënë re, ju nuk bëni eksperimente në roman, pra as që e shkon në mendje të shkruani roman postmodern. Trilli juaj është postrealist, veçse ironia në të është më e egër dhe më tallëse se në romanet postmoderne. Personazhet e trillit tuaj edhe janë dramatikë, edhe komikë. Njashtu është edhe rrëfimi i rrëfimtari (autorit). Po i njëjlojtë duket edhe përkufizimi i ngjarjeve dhe veprimeve të personazheve tuaj që janë shqiptarë, të cilët nuk përtojnë t'ia ngulin thikën njëri-tjetrit edhe kur nuk fitojnë asgjë nga kjo e keqe. Përqini, me këtë ironi dhe këtë vështrim dhe këto kritika, t'i bëni shqiptarët më të mirë dhe më të dobishëm për njëri-tjetrin?

Nga pyetjet që keni bërë nuk krijohet ndonjë ide e qartë se cilat prej veprave të mia i keni lexuar.

Jua përmend po që se dëshironi.

Jo, kjo nuk ka rëndësi, vetëm se do të kërkjoja prej jush kujdes më të madh në përdorimin e fjalëve të cilat pretendonin t'ia ktheni në terma letrarë. Ju thonin: "Trilli juaj është postrealist..." dhe më pas "Personazhet e trillit tuaj..." Në Kosovë studiuesit e letërsisë kanë një prijeje disi të çuditshme, që vetë të krijojnë terma letrarë për të dëshmuar kreativitetin. Në këtë rast, është mirë ta shikoni edhe një herë në fjalor kuptimin e fjalës trill, sepse unë nuk jam shkrimtar me trille dhe, kur shkruaj, nuk trilloj. Kuptimi i fjalës është negativ dhe i tillë mbetet edhe kur bartet në rrafshin letrar. Në këtë kuptim, në kuptimin letrar, trillimi është niveli më i ulët i motivimit të rrëfimit, ndërsa trilli është shkarje psikosomatike që çon në veprime të pamenduara. Për ndryshim nga këto "trille", unë rrefej i mbështetur në një imagjinatë krijuese, e cila nuk është as postmoderne, as postrealiste. As eksperimenti nuk është masë për të vlerësuar ose mohuar një vepër letrare. Në përgjithësi, përkufizimet dhe emërtimet e këtyra asnjëherë nuk kanë çuar peshë në letërsi dhe në procesin krijues, aq më pak të lexuesit i supozuar. Ato janë shpikur nga studiuesit letrarë për ta mbushur disi bjerren e kohës, ndërsa te ne u jepet më shumë rëndësi se kudo tjetër. Ja, po jua sjell dyshembuj nga letërsia botërore për ta vërtetuar këtë: Romani i Oskar Ualldit, "Piktura e Dorian Grejit", është shkruar në fund të shekullit XIX, kur nuk njihet as postmodernizmi dhe as postrealizmi si kategori dhe nocione letrare por, për mendimin tim, është një nga kryeveprat e letërsisë botërore, e cila edhe sot, pas kaq kohësh nga botimi, mund t'ia japë lexuesit kënaqësi artistike dhe dije filozofike më shumë se tona të tërë vepërash letrare e filozofike të këtij apo atij drejtimi. Në rastin tjetër, për Mishel Hollebekun e lexuar gjerësisht në Francë, një "denglxhi" që ua ka gjetur dellin e "humorit të keq" francezëve të frustruar, nuk thotë njëri është modern, postmodern,

realist apo postrealist. Ai thjesht lexohet për motive joletrare, kryesisht për mesazhe politike të "dizajnuara" me imagjinatë letrare ngaçë, aktualisht, për shkak të rritjes enorme të qarkullimit të informacionit, politika është bërë ushqim themelor për konsum të përgjithshëm. Por, sa jam në dijeni, francezëve nuk u bëhet vonë t'u japin romaneve të tij attribute postmoderniste, siç do të bënin te ne me shumë pasion teoriko-letrar, sikundër që nuk u dhanë attribute të tilla as romaneve të nobelistëve Modiano apo Le Klezio. Thënë me një fjalë, letërsia brenda vetes nuk i nënshtrë përkufizimet teorike, por një kreativitetin autorial dhe, në rastin e romanit, formën e përshtatshme të rrëfimit, gjuhën e përshtatshme të rrëfimit etj. Te romani, tradicionalisht, forma më e përhapur e rrëfimit përshin personazhet si bartës të veprimtimit. Këtë veçori e kanë të gjitha artet narrative, që nga antika e deri sot. Personazhet e mia natyrisht se janë shqiptarë, por që ata "ia ngulin thikën njëri-tjetrit", kjo nuk besoj të jetë e saktë. Ata, si të gjithë personazhet e romaneve të botës, jetojnë dhe veprojnë në një ambient jetësor me nxitje rrethanash polivalente, nëse mund të thuhet kështu, por kanë edhe specifika dhe veçori që i dallojnë nga masa e madhe e këtyre personazheve imagjinare, ndryshe nuk do të kishte arsye që të përfshiheshin në një rrëfim romani. Specifikat e tyre janë arsyeja pse ata ekzistojnë. Por çfarë janë ata? Njerëz që kanë jetuar dhe jetojnë me realitetin tonë, vetëm se herë-herë kanë edhe aftësinë e të vërejturit kritik ose gjykitimit ironik të këtij realiteti. Me një fjalë, unë përipiqem të mos bëj personazhe që i imponohen realitetit, por vetje që burojnë prej tij. Sido që të jetë, unë mendoj se shkrimtarët nuk është mirë të flasin gjerë e gjerë për procesin krijues, sepse në shumicën e rasteve nuk e shpjegojnë si duhet atë e, nëse shkrimtarët, që janë subjekti kryesor i këtij procesi, nuk arrijnë ta shpjegojnë si duhet këtë fenomen, mund ta merrni me mend se sa gjëra të kota thonë për këtë proces ata që nuk marrin pjesë në të...

Lindita Aliu-Tahiri më ka habitur me erudicionin

Studiuesja Lindita Aliu, më shumë se kushdo tjetër, edhe e ka lexuar më mirë, edhe është marrë më shumë me veprën tuaj, veçanërisht me romanin "Im atë donte Adolfin". Duke i bërë analizë kësaj vepre, ajo thotë, me të drejtë, se Kraja, duke paraqitur realitetin historik, krijon metafiksionin historiografik, i cili duket në romanin "Im atë donte Adolfin", po edhe në "Selvitë e Tivarit" e në të tjerë. Përpos kujtimit

Intervistë me profesorin, publicistin, dramaturgun Haqif Mulliqi (3)

KAM ENDE SHUMË PËR TË DHËNË DHE THËNË

Bisedoi: Musa KURHASKU

Epoka e re: Ju keni bërë një studim voluminoz mbi dramën shqipe në Kosovë dhe lidhjen e saj me mitologjinë. Çfarë është ajo që, sipas jush, e karakterizon një rrëfim mitik në dramën që e keni marrë si lëndë studimi?

Mulliqi: S'do mend se është vetë rrëfimi mitik ai i cili i ka karakteristikat që janë imanente në letërsinë rrëfimore, siç ka ndodhur, ta themi, edhe me Iliadën dhe Odisenë në të cilën, në mungesë të pjesës historiografike - nga fakti se në momentin e caktuar "historia" si shkencë nuk ekziston, me ç'rast, janë, të thuash, e vetmja gjurmë mbi diçka që ka ndodhur (!??), e që, në një epokë të caktuar, kanë mundur të konsiderohen edhe histori. Me këtë, në asnjë mënyrë nuk e mohoj punën e historikanëve, por dua ta them se në çaste të dhunës dhe të diktaturës, të thuash ka qenë e mundshme që të flitet me faktin historiografik për një ngjarje, por kjo ka mundur të bëhet përmes trillit artistik. Merreni Sfighën e gjallë të Rexhep Qosjes, ta themi, apo mënyrën se si ky autor iu qaset problemeve të ndarjes së shqiptarëve në disa shtete dhe mosmundësisë së komunikimit të tyre për shkak të "urave të rrënuara" nga pushtuesit, siç e paraqet ai te drama tejet interesante Beselam pse më flijojnë si dhe intencën e shqiptarëve për t'i ndërtuar ato. Dhe këtë e bën përmes legjendës së urës të cilën e ndërtojnë tre vëllezërit ustallarë ditën, por në mënyrë të mistershme rrënohet gjatë natës e që është diçka që, edhe mund të rrefehet si një përrallë e dëgjuar, por nga këndvështrimi i aktualitetit të autorit funksionon si kod mbi flijimin e njerëzve për një kauzë më të madhe dhe më të ndritur. Me këtë dua të them se, në dramën që unë kam marrë si lëndë trajtimi në studimin tim, miti, pikërisht për shkak të karakteristikave që ka, në çaste të caktuara është perceptuar si art dhe si diçka e mundshme në të njëjtën kohë. Megjithatë, fotografia mbi shumëkohësinë e mitit, në radhë të parë është art (dramaturgjia) e cila ndryshon në definimin spontan të mediumit të dramës dhe të teatrit në të njëjtën kohë. Kështu, në dramën e përmendura të Rexhep Qosjes, të Sinkopa dhe Gof të Pashkut, të Bregu i Pikëllimit e Teki Dervishit, Unë Halil Garria dhe Ora e Kukurvajtës të Beqir Musliut, të Një Antigone e re dhe Monedha e Gentit të Milazim Krasniqit, të Zeka i zi udhëton për në Babilon të Ymer Shkrelit apo edhe të Gjarpri i shtëpisë i Ajri Begut, e që janë vepra, kryekëput, fikionale, që në kontaktin e parë bëhemi të vetëdijshëm se mitosi në to apo rrjedha e ngjarjeve, që e ruan vëmendjen tonë, formësohet në një tërësi unike. Në mënyrë të vazhdueshme, hajt ta themi edhe ndonjëherë të nënvetëdijshme,

lexuesi bën përpjekje që nga ajo që ka lexuar deri më tashti apo edhe parë (në skenë) të ndërtojë një ekzemplar më të gjerë të domethënies simultane të mitit në dramë.

Në veprat që kam trajtuar në studimin tim, paçka se në dramaturgjinë shqipe ka edhe shumë vepra të tjera si këto që janë ndërtoar mbi mite dhe legjenda, disi më rezultojnë se: fillimi i një tregimi në dramë e paralajmëron fundin e caktuar dhe se tregimi nuk i përngjason shpirtit sipas teologjisë së natyrshme në ndonjë çast arbitrar të kohës që të jetojë përgjithmonë. Kjo tregon se në vazhdimësi presim që të vijmë deri te një pikë e caktuar në veprë, apo më mirë në fund të saj në të cilën, suspensionin linear e zgjidh unitetin e tërësishtëm të veprës dramatike e që shndërrohet në diçka që është e dukshme edhe konceptualisht. Ta kujtojmë se ky është ai momenti të cilin Aristoteli e ka quajtur anagnorisis, e që në rastin e dramave të sipërpërmendura të autorëve të respektuar më mirë është ta interpretojmë si rinjohje sesa si zbulim.

Autorë me përpjekje serioze për të treguar se mitet duhet të merren si mbështetje dhe dëshmi për studimin e zhanreve

Epoka e re: Profesor, vitin e kaluar po nga Shtëpia Botuese Armagedon janë botuar edhe katër komedi tuajat, ndërsa ju njiheni si autor që edhe dramën (në kuptimin e ngushtë të fjalës) dhe tragjedinë e shkruani njëllë suksesshëm. Do të donim të dinim se, sipas jush, ku qëndron dallimi ndërmjet "ndërthurjes" tragjike dhe asaj komike në një veprë dramatike?

Mulliqi: Me kërkesë të Berat Dakajt, drejtorit të shtëpisë botuese "Armagedon", po vjet i ka botuar edhe 18 drama të miat në një kolonë të vetme, ndërsa ky investim ka qenë i vet shtëpisë botuese, që do të thotë nuk është ndihmuar nga askush. Edhe aty janë edhe tragjeditë e mia, edhe dramën, edhe komeditë dhe ky veprim i Dakajt më ka bërë të ndihem vërtet mirë ngaqë nuk është punë e vogël që një autori t'i botohet një kolanë e tërë librash. Ndërsa, për sa i përket pyetjes suaj, unë mendoj se "ndërthurja" tragjike apo ajo komike në një veprë dramatike nuk paraqet një linjë të drejtë por, para së gjithash, një parabolë e cila, siç e thotë Fergasoni, në formë të maskave në maskat konvencionale. Bile ky teorianci mendon se te komedia ndërthurja është në formë të shkronjës U me veprimin i cili zhytet në lëvizje të thella dhe potencialisht tragjike që, befasisht, të bëjnë një kthesë të fuqishme duke vazhduar përpjetë e për të ecur drejt një përfundimi të gëzuar. Ndërsa tragjedia është, po



HAQIF MULLIQI

ashtu, në formë të shkronjës U, por të kthyer mbrapsht me veprimin të cilit i shtohet intensiteti nga kriza dhe kundërshtitë drejt peripecisë e, më pas, zhdirgjet drejt katastrofës, përmes një vargu të njohjeve dhe, rëndom, një vargu të pasojave të pashmangshme të asaj që ka ndodhur më herët. Mirëpo, në asnjë rast nuk mund të identifikohet diçka e re, por diçka që është e pranishme kaheerë dhe që me paraqitjen e sërishme apo edhe me të manifestuarit sjell deri në përfundim të veprës në një rrafsh me fillimin.

Epoka e re: Këtu shtrohet edhe pyetja se përse, nëse një autor i caktuar si Qosja, Krasniqi, Dervishi etj., e ka qëllimin që në veprën e tij të merret me një shfaqje mitike, si artist duhet ta krijojë një përzgjedhje racionale të mënyrës që me të cilën synon ta sendërtojë këtë veprim? Ju jeni ekspert i fushës, ndaj a mund të na thoni se çfarë ka në veprat e këtyre autorëve si dhe në mënyrat që kanë përdorur ata në krijimin e dramave të tyre, që e bën të pranishëm mitin?

Mulliqi: Më duhet ta them në krye të kësaj përgjigjeje se në veprat e Rexhep Qosjes, Beqir Musliut, të Teki Dervishit, të Milazim Krasniqit dhe të autorëve të tjerë me të cilët jam marrë në studimin tim, faktikisht kam hasur në mitologjizim të letërsisë, apo të autorëve që bëjnë përpjekje serioze të tregojnë se mitet të cilat interesojnë ata duhet të merren si mbështetje apo edhe dëshmi për studimin e zhanreve dhe të konventave të cilat i përdorin këta dramatishtë. Hajde ta përmendim këtu, ta themi, legjendën e murosjes së gruas në themelet e godinës që ditën ndërtohet e natën i tërë ndërtohet rrënohet, që e vendos Qosja te drama e tij Beselam pse më flijojnë. Kjo është një dramë tejet interesante që mitin e ka vetëm si pretekst, ngaqë vizioni i Qosjes është krejtësisht politik, ngaqë ai si autor bën përpjekje që me një urë t'i ndërlihdë dy brigjet e lumit të një vendi të ndarë, e që për mua ishin Kosova dhe Shqipëria, e për bashkimin e tyre në themelet të çështjes duhet të vendoset një fli, për çfarë Qosja e përdor mitin e moçëm shqiptar i cili zanafillën e ka te një tregim

bibli i Abrahamit. Kjo do të thotë se Qosja si autor e përdor një mit të vjetër për të krijuar kontekste të reja nacionale dhe politike të kohës së tij, ndërkohë që me shembuj eksplisit dhe të drejtpërdrejtë në veprë dhe një numri jashtëzakonisht të madh të pamjeve poetike na fton dhe na futë në një prej miteve më të njohura të viktimit të gruas, e që, ndonjëherë, na e lë përshtypjen edhe të flijimit të Andromedës apo edhe të Ifigenisë që janë viktima të kauzave të caktuara. Njëjtë mund të flitet edhe për dramën Një Antigone e re të Milazim Krasniqit, ku autori e përdor mitin e moçëm të Antigones duke e ricikluar atë në luftën e fundit në Kosovë në gjakimin e motrës së ushtarit të UÇK-së e cila, paçka se është e vetëdijshme se do ta pësojë, megjithatë kthehet në territorin e armikut, për ta gjetur dhe për ta varrosur vëllanë e vradë, ushtar. Në të dyja këto raste, sikurse edhe në dramën e autorëve të tjerë me të cilët jam marrë në studimin tim, krijohen indikacione mbi përdorimin e vetëdijshëm që i bëjnë formës konvencionale këtë dramaturgë e që na futë thellë në identitet.

Epoka e re: Profesor Mulliqi, a mund të thuhet se ekzistojnë dallime dhe ngjashmëri në përdorimin e mitit në dramë?

Mulliqi: Drama e sofistikuar nuk heziton që të futet në poetikë, në hermetikë, në filozofi dhe të bëjë lojë postmoderne me faktet historike, e që është drama e cila e trajton mitin si shtresë për të arritur te dorëshkrimi autentik i dramës. Diku në vitet e gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar me Anton Pashkun në dramaturgjinë tonë ndodhi futja në frymën e dramës moderne evropiane, e cila shkoj shumë më larg sesa qarku i letërsisë shqiptare në përgjithësi. Ky autor u pasua nga Rexhep Qosja dhe kështu, të thuash, hap pas hapi, u krijua një frymë krejtësisht e re në dramaturgjinë shqiptare e cila, bashkë me poezinë, edhe letërsinë tonë e bënte të konsiderohej moderne. Paçka se, në fillim edhe këta autorë, por edhe të tjerët që erdhën pas tyre, si Y. Shkrelit, B. Musliu, A. Begu, T. Dervishi, E. Kryeziu, e të tjerë, në

fillim dukej se po e imitonin një procedurë të "importuar" nga drama evropiane, në radhë të parë nga Andrej Zhidi dhe Zhan Zhirodu, megjithatë krijuan një identitet të fuqishëm dhe i dhanë tone të qarta të dramaturgisë sonë. Bile, nganjëherë mendoj se unë, personalisht, kam mësuar nga kjo dramaturgjia, edhe pse dramën e mia (hiç dramën Sistola), të thuash, që nga fillimi, iu takuan formave të tjera të dramës që në dramaturgjinë tonë erdhën përmes S. Beketit, A. Adamovit, E. Joneskos apo edhe E. Olbit duke përfaqësuar një frymë dhe një mendim fare tjetër filozofik në dramë. Ndërsa, autorët e sipërpërmendur, kryesisht, iu qasen trajtimit të miteve të moçme përmes të cilave bënë përpjekje të madhe që të definojnë një lloj të teatrit dhe lëvizjeje të re avangarde me një dimension të shprehur politik dhe shoqëror.

Nëse do të ktheheshim te studimi im dhe libri Teatri, drama dhe identiteti kulturor në Kosovë, duke analizuar dramën e autorëve të apostrofuar tashmë, mendoj se kam arritur të shkaqet e lindjes dhe vendi të cilin e ka drama e krijuar përmes miteve të ndryshme e që, në fakt, doli të jetë pikësnyim i analizës sime ngaqë mendoj se kam arritur te një moment, sipas të cilit, realisht del se te drama dhe poezia, sikurse te miti, analogjia dhe identiteti, paraqesin themelin e elementeve konceptuale që shpërfaqen, vazhdimisht, si figura të zakonshme retorike, krahasime si dhe metafora.

Epoka e re: Profesor Mulliqi, jo rrallë ka tone që e kontestojnë dramën e mirëfilltë kombëtare. Bile, ka edhe të atillë që e mohojnë ekzistimin e saj. Cili është mendimi juaj për këtë fenomen?

Mulliqi: E kam thënë me dhjetëra herë se dramën, në fakt, te ne e "vlerësojnë" dhe kontestojnë njerëz që nuk e lexojnë fare atë. Fundja, dramën është e vështirë për ta lexuar dhe kuptuar. Ndonjëherë probleme në këtë kanë edhe profesionistët. Por, sipas meje, nëse dramaturgjia jonë do t'i kishte vetëm këta autorë me veprat e të cilëve unë jam marrë në studimin tim, vetëm këta do të mjaftonin të themi se dramaturgjia jonë është e nivelit të regjionit dhe se shumë prej këtyre autorëve do t'u bënin nder edhe dramaturgëve të zhvilluara evropiane. Jashtë kësaj, unë mendoj se, gjithçka tjetër është mediokritet.

Epoka e re: Po ju, si autori më i botuar dhe më i inskenuar në historinë e dramës shqipe, ku e shihni veten?

Mulliqi: Mendoj se vendi im do të jetë aty ku dijetarë dhe studiues do të mendojnë se e kam vendin. Shpresoj se kam edhe shumë e shumë për të thënë, qoftë si autor dramash apo edhe regjisor.

(Fund)

INTERVISTË ME XHEVDET BAJRAJN (3)

PËR TË FOLUR PËR POEZINË MEKSIKANE DIKUSH DUHET T'I PAGUAJË KAFETË, APO NDOJË KRIKËLL BIRRE

Sa e njihni letërsinë aktuale shqipe?

Asnjëherë nuk jam shkëputur nga tradita. Disa me fjalën traditë nënkuptojnë që artisti duhet të sillet dhe të veprojë brenda një propozimi estetik i cili mbretëron me decenie apo me shekuj, pra duhet të sillet brenda një moçali që dikur moti, mbase ishte liqen! Kjo është diçka e sëmurë, është kundër natyrës së artit. Poeti duhet ta pranojë trashëgiminë letrare, ta dominojë propozimin estetik të kohës në të cilën jeton dhe të përpiqet ta përshkojë aktualitetin, ta hapë një shteg të ri nëpër të cilin pastaj do të kalojnë të tjerët, ata do ta bëjnë të njëjtën, pastaj do të vijë ca të tjerë që do të veprojnë njësoj. Kjo shihet më së bukur në shembullin e Spanjës, që nga romantizmi i vonë spanjoll, gjenerata e '98, 14, 27, 36, 40, 50 e shtojta nga një dekadë. Çdo gjeneratë "i kërkon përgjegjësi" gjeneratës së mëparshme, debaton me të, qoftë ai edhe monolog, i merr të mirat e gjeneratës së mëparshme, i modifikon po qe nevoja dhe ia përcjellë tutje, bashkë me kontributin e vet gjeneratës së ardhshme. Pastaj këtë të fundit e presin të njëjtat detyra apo obligime. Përfundimisht bëjnë Aligieri, Servantesi, Shekspiri, disa rusë, Kafka e ndonjë tjetër, ata vazhdojnë të ngasin veturën e kohës dhe neve na shohin në pasqyrën që ua mundëson të na shohin neve prapa.

Nejse, përgjigjja është: e njoh mirë, po nuk zë vend vetëm në këtë intervistë.

Cilat vepra të shkrimtarëve meksikanë do të na sugjeronit t'i përkthenim në gjuhën shqipe?

Vepra komplete (dy libra) të Juan Rulfo's i cili është i përkthyer në Kosovë para nja 30 vjetëve dhe i botuar nga shtëpia botuese e Rilindjes. Për ta shijuar këtë duhet të njihet Meksika, pra nuk mjafton të njihet gjuha spanjolle sepse këtë vepër nuk mund ta shijojnë as lexuesit e pakultivuar nga jugu apo veriu i Meksikës, e lëre më argjentinasi, kolumbianët, peruanët e aq më pak spanjollët. Pra, përkthyesi duhet të dijë pak më shumë nga sociologjia e letërsisë.

Po ndonjë vepër e ndonjë shkrimtari tjetër meksikan që do të duhej të fliste shqip?

Panairi, Hose Huan Arreola (Juan José Arreola), Betejat në shkretëtirë nga Hose Emilio Paçeko (José Emilio Pacheco, poezia e tij gjithashtu), Rajoni më transparent, Karlos Fuentes (Carlos Fuentes), Lajme nga perandoria, Fernando del Paso dhe shumë poezi, por për të folur

për poezinë meksikane dikush duhet t'i paguajë kafetë, apo ndonjë krikëll birre!

Keni botuar pesë-gjashtë libra me poezi. Disa prej tyre i keni shkruar dhe botuar sa keni qenë në Kosovë, disa të tjerë tashti që jetoni në Meksikë. Më frymëzim keni kur shkruani në vendlindje apo kur jeni larg saj?

Kam botuar më shumë se kaq... Kur vij në Kosovë, me hapin tim të parë në atë tokë ndihem si fëmijë i lumtur, i stërlumtur, qëndroj një muaj e ca dhe kur ndahem me të unë jam plak i sëmurë. Kur qëndroj 5-6 muaj, kjo ndodh kur e marr vitin sabatik, nis me më dhimbte jeta, hapet një plagë nga e cila kullon një poezi intime, nganjëherë e shkruaj, por shpesh ato nuk funksionojnë në gjuhën spanjolle, kështu që jam i detyruar të kthehem në pikën ku këto dy gjuhë mund të bashkëjetojnë në paqe, brenda meje, edhe kjo më dhemb. Pse nuk shkruaj pra vetëm në gjuhën shqipe? Përveç provokimit profesional, se nuk është këtu në pyetje vetëm Meksika, por i tërë një kontinent, një gjuhë, një letërsi e madhe. E Meksika e di që e kam sjellë me vete Kosovën, më ka pranuar si të sajën, më ka dhënë më shumë se që kam mundur të ëndërroja. E kam një borxh etik të madh ndaj këtij vendi të mrekullueshëm. Deri në frymën e fundit do të përpiqem të mbetem njeri, paçka që e barti etiketën e turpit të të qenit njeri. Gjithashtu, e ndiej si borxh etik t'u përkujtoj këtyre që na përfaqësojnë në bisedime me Serbinë, se agresori dhe viktimat nuk mund të jenë të njëjtë, në asnjë situatë.

Nuk shkruaj skenar. Më duhet ta shkruaj një dramë

Keni shkruar skenar për ndonjë film meksikan ose për serial televiziv?

Është një keqkuptim dhe ndihem shumë keq për këtë. Dikush në Wikipedia e ka shkruar biografinë time dhe më ka prezantuar edhe si skenarist. Mbase ky keqkuptim ka ndodhur kur në Festivalin e Filmit në Meksiko Siti, në mungesë të dy skenaristëve të filmit në të cilin mora pjesë, njërit spanjoll dhe tjetrit kanadez, u ngjita në skenë ta marr çmimin, sipas kërkesës së tyre. Ata më herët shfaqën dëshirën që nëse shpërblehen, të paraqitem unë në vend të tyre. Kjo është e tëra. Përndryshe, i çmoj shumë skenaristët e llojit të Tonino Guerrës, Abdullah Sidranit e ca të tjerëve, por për shumicën e tyre mendoj se janë shkrimtarë të dështuar.



XHEVDET BAJRAJ

Keni provuar të shkruani për luftën e fundit në Kosovë, për ndonjë segment të luftës, për shembull, për gratë e dhunuara, apo për të pagjeturit?

Që skenar nuk shkruaj u kuptuam. Po, jeta është shumë e shkurtër që të provoj të merrem me këtë punë e cila, mbase, sjellë shumë lekë, por ja që mendoj që lekët nuk janë objektivi im kryesor në jetë. Ndërsa më duhet ta shkruaj një dramë, e kam edhe këtë një borxh moral për të cilin nuk dua të flas, edhe pse në përgjithësi për borxhet e tjera morale mund të flas, ato na kthejnë në fëmijërinë e njerëzimit, atëherë kur perënditë tona dhe engjëjt ecnin bashkë me ne dhe kafshët e tjera (me kushërinjtë tanë që tashmë i ndiejmë të largët).

Cilët libra të autorëve botërorë i keni lexuar në dy vjetët e fundit?

Për orën e fundit m'u desh ta lexoja për të satën herë Anatominë e ndikimit të Harold Blumit (Harold Bloom) dhe Varreza detare të Pol Valerit (Paul Valéry). Desha s'desha, lexoj dhe rilexoj shumë.

Cilët libra të autorëve botërorë, të gjallë dhe të vdekur, i lexoni ende? Dhe pse duhet t'i lexojmë edhe ne?

Nikos Kazancakis (Nikos Kazantzakis) ta përkujton rolin e shkrimtarit brenda një shoqërie dhe çmimi që duhet të paguajë një shkrimtar. Shekspiri, Aligieri, Servantesi, Alber Kamyja, Ualt Uitmani (Walt Uitman), Kafka, Bodleri... edhe nja 15 a njëzet shkrimtarë të tjerë. Ata na përkujtojnë çka kemi qenë, çka jemi dhe kah po shkojmë. Që jeta e

njeriut ka mundur të jetë e bukur, po ja që nuk është; që liria na përkujton, vetëm na përkujton që jeta është e mrekullueshme, gjithashtu, në pjesën më të madhe, ajo ua përkujton njerëzve se sa mund të durojnë të shkërdhehen.

Cilët filma i konsideroni më të mirët që janë prodhuar nga qendrat e prodhimit të filmave në botë? Dhe, për ç'arsye janë më të mirët?

La vita è bella e Roberto Benigni dhe Cinema Paradiso e Xhuzep Tornado's (Giuseppe Tornatore). I pari ma përkujton luftën në Kosovë, i dyti fëmijërinë në Rahovec. Përndryshe, shikoj shumë filma dhe më pëlqejnë regjisorët si: William Wyler, Sam Peckinpah, Akira Kurosawa, Federico Fellini, Oliver Stone, Francis Ford Coppola, Stanley Kubrick, Alan Parker, David Lynch, Milos Forman, Martin Scorsese, Brian De Palma, Woody Allen, Steven Spielberg, Ridley Scott, Sergio Leone, Wim Wenders, Spike Lee, Vëllezërit Koen, Quentin Tarantino, Guy Ritchie etj. etj. Për aktor s'po ju flas: Brando, De Niro, Pacino, Jack Nicholson, John Cusack dhe lista natyrisht, është shumë më e gjatë se e regjisorëve.

E diela është dita e muzikës e Vjollcës dhe dita ime e pijes

Çfarë muzike dëgjoni dhe çfarë lloj pijesh konsumoni?

Do të shkrihem, të venitem... Muzika është pjesë e rëndësishme e jetës sime, e poezisë sime. Ajo ma ka mundësuar ta bëj hapin e parë drejt poezisë,

drejt lirisë. Ishte Rock n Roll-i, Rock-u dhe Blues-i ato që ma mbanin dritën ndezur nëpër shtigjet e ngushta të jetës nëpër të cilat kam kaluar, me apo pa dashje. Nga muzika shqipe, kur kam mysafirë jo shqiptarë në shtëpi, e dëgjojme Bojken Lakon, Endrin dhe Stefin... muzikë nga jugu. Të dielave, si sot, është dita e Vjollcës, gruas sime. Unë e shtroj tryezën e ajo e lëshon një video me muzikë shqipe në YouTube pastaj me orë të tëra, automatikisht, ndërrohen videot. Natyrisht, është dita e saj e muzikës dhe dita ime e pijes.

Përpos dukjes fizike, sa ma kanë komentuar disa zonjusha shqiptare dukjen tuaj, për to jeni tip shumë tërheqës. Nuk do të vijmë t'i pyesim ato, po duam të dimë çfarë thonë meksikanet për ju dhe për racën tonë - shqiptarët?

Unë dukem si meksikan. Por, për racën tonë, kur e shohin gruan dhe fëmijët e mi, thonë fjalë shumë të mira, natyrisht, jemi shumë të bukur brenda racës sonë. Përndryshe, çdo racë është jashtëzakonisht e bukur. Proveni të bëni dashuri me to dhe do ta kuptoni.

Si do të donit ta përfundonim këtë intervistë?

Me një doll: Gëzuar dhe, mirupafshim Te Kafetë e rakisë!

Paçi shëndet të mirë, profesor!

Ju falemnderit! Gjithë të mirat për ju dhe për lexuesit e revistës!

(Intervista është marrë nga numri i katërt i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia". Fund. Intervistoi: B. Armagedoni)

LIDERËT BOTËRORË QË KANË NOFKA

Liderëve të vendeve të Bashkimit Evropian u pëlqen ta ruajnë seriozitetin e të projektojnë një imazh të tillë në publik por, ndonjëherë, as këta njerëz të fuqishëm nuk i shmangin dot nofkat e publikut, apo edhe ato të dala nga radhët e vet partive të tyre.

Presidentin francez Emanuel Macron e quajnë "Jupitarian", mbështetur kjo në teorinë e tij të "Jupiterit", sipas së cilës, kreu i shtetit është autoriteti suprem. Kryeministrin spanjoll Pedro Sanchez e quajnë "The Revenant", duke iu referuar filmi me Leonardo DiCaprio, ku personazhi kryesor mbijeton pavarësisht prej shanseve tmer-rësisht të vogla për të mbetur gjallë pas një sulmi aq të dhunshëm.

Angela Merkelin e thërrasin "Nëna" për shkak të pamjes së saj, qëndrimit dhe të folurit të qetë e të shtruar.

Antonio Costa është kreu i parë portugez i ekzekutivit pa tipare kaukaziane, e kjo ka bërë që disa ta quajnë "Gandi i Lisbonës".

Por gjetja më e goditur në listën e nofkave konsiderohet ajo e kryeministrit hungarez Viktor Orban. Që përpara batutës së kryetarit të Komisionit Evropian Jean Claude Juncker në samitin e Rigës në vitin 2015, ku e përshëndeti si me shaka duke i thënë "ç'kemi diktator", disa qytetarë të tij ia kishin vënë nofkën me kohë dhe nuk e thërrisnin Viktor, por "Viktatori".



VENDET QË I PAGUAJNË MË SHUMË MËSUJESIT

Edukimi dhe arsimimi i brezave të rinj është shtylla kryesore që garanton jo vetëm mbijetesën e një populli, por edhe rritjen e mirëqenies së tij. Sado të ndryshojnë prioritetet e një qeverisjeje, arsimimi është gjithnjë e aty, një prej tyre, madje edhe kur bëhet fjalë për vendet më të zhvilluara të planetit. Por cilat janë vendet që vlerësojnë më shumë ata që përhapin dijen ndër breza të rinj?

World Economic Forum ka bërë renditjen e 10 vendeve që paguajnë më shumë mësuesit në bazë të të dhënave të publikuara nga Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik.

1. Kanada, paga vjetore për mësuesit është 39,179 dollarë
2. Holandë, paga vjetore për mësuesit është 39,205 dollarë
3. Australi, paga vjetore për mësuesit është 40,874 dollarë
4. Spanjë, paga vjetore për mësuesit është 42,002 dollarë
5. SHBA, paga vjetore për mësuesit është 43,678 dollarë
6. Danimarkë, paga vjetore për



mësuesit është 46,914 dollarë

7. Norvegji, paga vjetore për mësuesit është 47,445 dollarë

8. Gjermani, paga vjetore për mësuesit 61,589 dollarë

9. Zvicër, paga vjetore e

mësuesve në këtë vend është 69,865 dollarë.

10. Luksemburg, paga vjetore e

një mësuesi është 79 mijë dollarë. Për ata me përvojë shkon deri në 137 mijë dollarë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

TOTTENHAM - CHELSEA

1

AMIENS - ANGERS

1

BROMLEY - WREXHAM

3+

Vazhdon 'gjahu' i klubeve të Superligës

KF Gjilani të hënën i ka realizuar dy transferime nga futbollit i Shqipërisë, kurse Llapi e ka regjistruar një transferim dhe dy largime. Krizën e Ferizajt e ka shtuar edhe më shumë Afrim Tovërlani, i cili ka vendosur të largohet ky klub

**EPOKA E RE****Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 7 JANAR - Klubet e IPKO Superligës së Kosovës në futboll e kanë vazhduar "gjahun" e përforcimeve edhe të hënën. Skuadrat më aktive ishin Gjilani dhe Llapi. Skuadra nga Anamorava është përforcuar me dy futbollistët nga Shqipëria: Vilson Lilën dhe Klejdi Koçi. "Vilson Lila luan në pozitën e mbrojtësit të qendrës dhe vjen nga klubi i Kastriotit nga Superliga e Shqipërisë. 29-vjeçari ka bërë karrierë brenda Shqipërisë, ku më parë ishte edhe pjesë e Kukësit. 19-vjeçari Klejdi Koçi luan në pozitën e mesfushorit dhe vjen nga shkolla e futbollit nga Tirana, KF Therm Tirana, ku ndër vite ishte lojtar i dalluar në generatën e tij dhe kishte spikatur me paraqitjet e tij në kategorinë e juniorëve në Shqipëri", thuhet në njoftimin e KF Gjilani.

Skuadra e Llapit vazhdon të jetë e para për ndryshime në këtë afat kalimtar. Kjo skuadër ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me sulmuesin Miran Maksuti. Qendërsulmuesi nga Tetova ishte pjesë e Renovës, ndërsa më parë ka luajtur edhe për skuadrën e KEK-ut. Të hënën klubin nga Podujeva e ka braktisur sulmuesi Alban Rexhepi dhe mbrojtësi Dardan Jashari. Ky i fundit ka thënë se ndihet krenar që po largohet nga kjo skuadër me kokën lart, pasi në secilën ndeshje ka dhënë maksimumin. "Pas katër vjet e gjysmë pjesë e këtij klubi, sot edhe zyrtarisht po largohem për një rrugëtim të ri në karrierën time. Për gjatë këtyre katër vjetëve e gjysmë kaluam shumë çaste të mira, gëzimi e hidhërimi, u shpallëm kampionë të Ligës së Parë, arritëm në finale të Kupës, ishim gjithnjë synuesit kryesor për titull, por tash është mbyllja e një kapitulli shumë të rëndësishëm në karrierën time. Falënderim i madh i

takon ish-kryetarit të klubit, Nexhat Dumnicës, kryesisë së vjetër dhe aktuales, ish-trajnerit Tahir Batatina, të gjithë trajnerëve që punuam së bashku, lojtarëve. Falënderim i veçantë për qytetin e Podujevës dhe tifozët 'Legjendat' që për këta katër vjet e gjysmë më bënë të ndihem si në shtëpinë time. Po largohem me shumë krenari sepse asnjë ndeshje nuk e kam përmbyllur pa e dhënë maksimumin, duke mbajtur me dinjitet e krenari fanellën e klubit të Llapit", ka deklaruar Jashari.

Pas vështirësive financiare dhe mungesës së një organizimi të mirëfilltë nga skuadra e Ferizajt është larguar trajneri Afrim Tovërlani. "Toki" ka thënë se po largohet nga ky klub për faktin se obligimet ndaj futbollistëve nuk janë kryer dhe se nuk janë bërë pesë transferimet e parapara të bëhen deri më 31 dhjetor. Stërvitet i kanë filluar edhe Prishtina dhe Drenica nga Skenderaj.

SHKURT

Gjyqtarët e hendbollit fillojnë vitin me garat evropiane

Një hapje pozitive të vitit e kanë bërë zyrtarët e ndeshjeve të Federatës së Hendbollit të Kosovës. Bëhet fjalë për gjyqtarët Erdoan e Arsim Vitaku që më 5 janar e kanë drejtuar takimin në mes të skuadrës hungareze Siofok KC Hungary dhe asaj daneze Herning-Ikast Handbold. Ndashja i takoi xhiros së parë të fazës grupore të Kupës së EHF-së (EHF Cup) për hendbolliste. Çifti Vitaku për delegat e kishin Aco Nikolovskin e Maqedonisë, ndërsa janë vlerësuar për paraqitjen.

Shaqiri në garë për transferimin më me ndikim në Premierë Ligë

Xherdan Shaqiri pa dyshim se ishte një prej transferimeve më të qëlluara të verës. Futbollisti nga Zhegra e Gjilanit, që kaloi nga Stoke City te Liverpooli në afatin kalimtar veror, është shndërruar në një nga lojtarët kyç të Liverpoolit. Shaqiri, që iu desh të luftojë për një vend në formacion, tashmë ka filluar ta fitojë besimin e trajnerit Jurgen Klopp. Anësori i kombëtares së Zvicrës ishte heroi i të kuqve ndaj 'Djajve të Kuq' në derbin e madh të Anglisë, ku i shënoi dy gola. 27-vjeçari në Premierligë ka qenë mjaft produktiv, me 6 gola e 2 asistime në 16 paraqitje, kurse në total ka 6 gola e 3 asistime në 20 ndeshje. Në faqen zyrtare të "Sky Sports"-it në 'Twitter' është postuar një anketë ku mund të votohet për transferimin e verës me më së shumti ndikim deri tani. Përveç Shaqirit, aty janë edhe portieri i Liverpoolit, Alisson, mesfushori i Leicesterit, James Maddison, si dhe Lucas Torreira i Arsenalit.

Juve vendos çmimin e Dybalas

Paulo Dybala është lojtari që ka rënë më së shumti në hije te Juventusit, pas ardhjes së Cristiano Ronaldos. Argjentinasit ka arritur të shënojë vetëm dy gola. Shumë epike të mëdha janë vënë në lëvizje për 25-vjeçarin, ku Bayern Munchen dhe Manchester City shihen të jenë kandidatë seriozë për transferimin e tij. Gjithsesi, sipas asaj që raporton "Tuttosport", drejtuesit bardhezinj kanë refuzuar çdo ofertë në drejtim të Dybalas dhe kanë vendosur një çmim fillestar ku mund të nisë "ankandi". Për Juventusin, ofertat në drejtim të sulmuesit argjentinas duhet të jenë të paktën 100 milionë euro.

Përforcohen Prishtina, Ylli dhe Ponte Prizreni

PRISHTINË, 7 JANAR - Ashtu sikurse në elitën e futbollit, edhe në atë të basketbollit po vazhdojnë përforcimet. Skuadra kryesuese në Superligë, Z Mobile Prishtina, ka paraqitur për regjistrim lojtarin ndërkombëtar Ahmed

Muhammed Bashir nga ShBA-ja, i cili së fundi është paraqitur në Argjentinë. Lojtari i lartpërmendur mund të regjistrohet në Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK) dhe të paraqitet për KB Z Mobile Prishtina pas plotësimit të kriterëve në bazë

të Rregullores mbi regjistrimin e lojtarëve në FBK. Ndërsa edhe KB Golden Eagle Ylli ka paraqitur për regjistrim lojtarin ndërkombëtar Holloman Garrius De Marquise nga ShBA-ja, i cili së fundi është paraqitur në Lebanon. Skuadra

tjetër që ka paraqitur për regjistrim një lojtar është KB Ponte Prizreni. Kjo e fundit është përforcuar me lojtarin nga ShBA-ja, Malcom Isaiah, i cili së fundi është paraqitur në KB Ostrava në Republikën e Çekisë.



Robbeni: Jam i lumtur që kam oferta

MUNCHEN, 7 JANAR - Interi është duke u interesuar për futbollistin e Bayern Munchenit, Arjen Robben. Skuadra italiane po tenton ta sjellë 35-vjeçarin në "San Siro" në fund të sezonit si lojtar të lirë. "Me të vërtetë,

Jam shumë krenar dhe i lumtur që po marr oferta. Javët e fundit kanë qenë shumë intensive, sidomos për babanë tim, i cili është agjenti im, por është bukur të dëgjosh që ka klube që interesohen. Për mua, e

ardhmja është akoma e hapur. Ende jam duke pritur. Dua të pres dhe të fokusohem që të jem në formë, të rikthehem në skuadër dhe të luaj futboll. Nuk e di kur, por do të marr një vendim. Nuk do të pres deri në

fund të sezonit sepse kam familje dhe duhet ta planifikoj lëvizjen fillimisht. E përsëris, jam i privilegjuar dhe me fat që klube të mëdha kanë shfaqur interesim për mua", ka thënë Robbeni.



Modriqi: Kjo është arsye pse Reali nuk po shkëlqen

MADRID, 7 JANAR - Mesfushori kroat i Real Madridit, Luka Modriq, nuk e mban shiritin e kapitenit, mirëpo përmes deklaratave, pas disfatës që pësoi klubi madrilen, ai u soll si një kapiten jashtë fushe. Fituesi i "Topit të Artë" doli në publik dje pas disfatës së Real Madridit me rezultat 2-0 kundër Real Sociedadit dhe me deklaratat e tij i nxitu edhe më shumë fjalët për krizën brenda klubit madrilen. Kroati e ndau fajin dhe përgjegjësinë për paraqitjet e rezultatet e dobëta me bashkëlojtarët e tij, duke pranuar se të gjithë duhet të mbajnë përgjegjësi për pikët e humbura. Modriqi theksoi se skuadra ka nevojë të përmirësohet në disa gjëra. "Është problemi ynë, por nuk është vetëm kaq, pasi që ka edhe gjëra të tjera. Para kësaj, rastet e mira përfundonin me gola, por tani nuk po ndodh kjo gjë, kështu që ne duhet të jemi më të mirë para portës. A mund të zgjidhet kjo gjë me transferimin e lojtarëve të rinj? Kjo nuk është puna ime, pasi ka shumë njerëz që vendosin për këto gjëra. Ne kemi nevojë për më shumë unitet në fushë, pasi që çdo ndeshje jemi duke pranuar gola dhe nuk po arrijmë të kthehemi në lojë", ka thënë Modriqi. "Ka shumë lojtarë të cilët nuk janë duke performuar në nivelin e tyre më të mirë dhe unë jam i pari në këtë listë. E di se duhet të përmirësohet dhe jam



këtu për ta marrë këtë përgjegjësi. Duhet të përmirësohemi në aspektin mendor dhe fizik. Duhet ta marrim çdo ndeshje me radhë dhe të mos mendojmë për Barcelonën ose ekipet e tjera që janë para ndesh. Duhet ta ngremë nivelin e lojës tonë dhe të jemi më të mirë mendërisht sepse kemi mjaft cilësi dhe klasë në skuadër që të mund ta përmirësojmë këtë situatë", ka deklaruar ai. Modriqi foli edhe për trajnerin aktual te Real Madridit, duke thënë se ai nuk mund të shënojë gola në vend të futbollistëve. "Trajneri është duke bërë punë të mirë dhe

na ka përgatitur mirë për ndeshje. Por, ai nuk mund t'i shënojë golat për ne. Ai nuk mund t'i shmanget asaj që po ndodh në fillim të ndeshjes sepse ai është duke e bërë punën e tij. Jemi ne ata që luajmë në fushë. Ka arsye që e sqarojnë pse nuk jemi në formë të mirë dhe gjyqtari nuk e pati paraqitjen e tij më të mirë sot, por problemi ynë nuk është ai apo VAR-i, edhe pse ata nuk na kanë ndihmuar aspak. Problemi ynë është diku tjetër. Shumë prej nesh nuk jemi duke luajtur në nivelin më të lartë dhe ky është një problem", ka deklaruar Modriqi.

Nuk kanë të ndalur Toronto dhe Clippersat



TORONTO, 7 JANAR - Toronto Raptorsi nuk di të ndalet, teksa këtë herë ka mundur 121-105 Indiana Pacersin dhe ka shkuar në kuotën e 30 fitoreve. Ndryshe është situata te Los Angeles Lakers, që pa LeBron Jamesi ka marrë vetëm një fitore në ndeshjet e fun-

dit. Këtë herë ka mposhtur Minnesota Timberwolvesin 108-86. Karl-Anthony Towns (28 pikë, 3 asistime, 18 topa të rikuperuar) dhe Andrew Wiggins (28 pikë) arritën ta 'likuidonin' Lakersin. Tobias Harris (28 pikë, 2 asistime, 9 topa të rikuperuar) udhëhoqi Los

Angeles Clippersin në fitoren ndaj Orlando Magicut me rezultatin 106-96. Oklahoma City Thunderi është befasuar nga Washington Wizardsi, që fitoi 98-116. Paul George (20 pikë) dhe Russell Westbrook (22 pikë, 13 asistime, 15 topa të rikuperuar) nuk e ndalën humbjen e skuadrës së tyre. Për Wizardsin spikatën Bradley Beal dhe Otto Porter Jr., të cilët shënuan 25 dhe 20 pikë.

REZULTATET

Minnesota - Los Angeles Lakers	108-86
Chicago Bulls - Brooklyn Nets	100-117
Los Angeles Clippers - Orlando M.	106-96
Atlanta Hawks - Miami Heat	106-82
Oklahoma City Th. - Washington W.	98-116
Toronto Raptors - Indiana P.	121-105
Phoenix Suns - Charlotte H.	113-119

SHKURT

Kukësi konfirmon largimin e Shkodrës

Mesfushori Donjet Shkodra nuk do të jetë pjesë e Kukësit për sezonin pranveror. Klubi shqiptar e ka konfirmuar largimin e futbollistit nga Kosova. "Donjet Shkodra zyrtarisht nuk është më pjesë e skuadrës së FK Kukësit. Marrëveshja në mes të klubit tonë dhe kosovarit ka përfunduar. 29-vjeçari, i cili iu bashkua skuadrës sonë gjatë sezonit të kaluar, është aktivizuar në 46 ndeshje në të gjitha kompeticionet, duke arritur të shënojë tre gola. FK Kukësi falënderon Donjet Shkodrën për kontributin e dhënë me skuadrën tonë dhe i uron suksese në karrierë", thuhet në njoftimin e Kukësit.

Atletico mendon shitjen e Lamarit

Tek Atletico Madridi është hapur një çështje që lidhet me Lemarin. Francezi që u ble jo pak, por 70 milionë euro nga Monaco në verën e kaluar, nuk po bind në fushë duke shfaqur edhe dyshime për trajnerin Diego Simeone. Edhe në ndeshjen e fundit me Sevillan lojtari u zëvendësua në minutën e 60, pa lënë gjurmë në fushë dhe mësohet se drejtuesit po mendojnë edhe ta shesin. Ata presin një sinjal nga lojtari për pjesën e mbetur të sezonit dhe nëse situata nuk ndryshon, shitja e tij duket e pashmangshme teksa ka ekipe të Premierë Ligës që e pëlqejnë lojtarin francez.

Eto'o: Trajnerët me ngjyrë shihen si njerëz të dorës së dytë

Samuel Eto'o është një ndër sulmuesit më të mëdhenj të historisë së futbollit, i cili vijon ende të luajë edhe pse ka 37 vjet. Aktualisht, kamerunasi aktivizohet në Lindjen e Mesme, me ekipin e Katar SC. Së fundmi, sulmuesi ka folur për mediet në lidhje me racizmin, sidomos pas ngjarjeve të ndodhura në Serinë A, me Kulibalin. Eto'o ka folur për këtë çështje dhe ka thonditur disi me deklaratat e tij, duke thënë se racizmi është shumë i pranishëm në futboll, madje te trajnerët mund të jetë më shumë se te lojtarët. Sipas 37-vjeçarit, trajnerët me ngjyrë nuk preferohen nga klubet dhe konsiderohen si njerëz të dorës së dytë. "Disa ish-lojtarë me ngjyrë nuk duan të bëhen trajnerë, edhe pse atyre u pëlqen. Ka shumë trajnerë në Afrikë të cilët i kanë të gjitha kualifikimet e duhura, por thjesht nuk kanë besim tek ata, ndryshe nga trajnerët e tjerë. Trajnerët me ngjyrë janë parë gjithmonë si qytetarë të dorës së dytë. Gjithsesi, unë fitova shumë në Evropë si lojtar dhe dëshiroj ta bëj të njëjtën gjë edhe si trajner", ka thënë Eto'o.

Arsenali ofron 65 milionë për Jamesin

Arsenali është gati të paguajë një shumë të lartë për futbollistin James Rodriguez, i cili aktualisht është në Bayern Munchen në formë të huazimit. Mediet në ishull kanë zbuluar se klubi londinez i ka gati 65 milionë euro për Jamesin. 27-vjeçari në këtë stinor me klubin "bavarez" ka shënuar tre gola dhe ka bërë dy asistime në 11 paraqitje. Mirëpo duket se klubi gjerman nuk do ta blejë përfundimisht kartonin e plotë të lojtarit.

Milani fillon operacionin për transferimin e Piatekut

AC Milan është futur në garë për të nënshkruar me sensacionin e Genoas, Krzysztof Piatek. "Gazzetta dello Sport" raporton se kuqezinjët tashmë kanë filluar negociatat për transferimin e sulmuesit polak. Genoa verën e kaluar pagoi vetëm katër milionë euro për Piatekun, por tani me shumë mundësi nuk do ta shesë për më pak se 40 milionë euro. Sulmuesi ka shënuar 13 gola në gjysmën e sezonit të parë në Serinë A, vetëm Cristiano Ronaldo është treguar më i mirë se ai me 14 gola.



BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.





REPUBLIC OF KOSOVO

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Procurement Name: Procurement of Implementer for District Heating Metering

Procurement Reference: RFP / MFK /2018/ QCBS / No. 021

Prishtina, Kosovo
05 January 2019

- 1) The Government of Kosovo has received grant funding of USD\$49,000,000.00 (Forty-Nine Million United States Dollars) from the Millennium Challenge Corporation (MCC) of the United States Government to support Kosovo through a Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability. The Millennium Foundation of Kosovo (MFK), the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, intends to apply parts of the proceeds of the funds to payments for Contracts for Goods, Works and Services.
- 2) The Threshold Program in Kosovo is a \$49 Million grant that consists of two projects, the Reliable Energy Landscape Project and the Transparent and Accountable Governance Project.
 - a) Reliable Energy Landscape Project: Demand for electricity significantly surpasses supply in Kosovo, and the country struggles with the reliability of its energy supply. This project encourages greater household energy efficiency and facilitates the switch to non-electric sources of heating through a pilot activity. MCC's investments also work to bolster private-sector participation in the power sector by exploring barriers to finance for independent power producers, and create opportunities for women to participate in the energy sector through both employment and entrepreneurship and
 - b) Transparent and Accountable Governance Project: Government decision-making is often opaque, leading to distrust by the private sector and civil society, and high perceptions of corruption. Kosovo's judiciary is one of the country's least trusted institutions. This project supports the implementation of a case management information system to make judicial information publicly available, and improvements to the collection and reporting of environmental data to the public. An open innovation competition will let the government pose their challenges to civil society and private sector stakeholders to propose creative, data-grounded solutions, which can be a model for more productive partnerships between government and civil society.
- 3) MFK intends to use a portion of the grant provided through the Threshold Program to fund Procurement of Implementer for District Heating Metering services from a firm/organization ("Consultant").

The Millennium Foundation Kosovo (MFK) is seeking financial and technical proposals to provide project management and technical assistance services for the District Heating Metering (DHM) Activity. The objective of this Request for Proposals (RFP) is to select an Implementer (IC) to manage the DHM Activity. The IC shall furnish all required personnel, services, materials, travel, office space and logistics necessary to implement this activity. The IC services will be required over three years, including the Pre-Implementation and Implementation Phases. Work is expected to start in the beginning of 2019. The Implementer and its key staff will be based and provide services in Prishtina.
- 4) This RFP follows the General Procurement Notice that appeared in dgMarket and UNDB Online on 14 September 2018 and local newspapers "Koha Ditore" and "Epoka e re" on 17 September 2018.
- 5) The Contract duration shall expire on 30 September 2021.
- 6) This RFP is open to all eligible entities ("Consultants") who wish to respond. Subject to restrictions noted in the RFP, consultants may associate with other consultants to enhance their capacity to successfully carry out the assignment.
- 7) A Consultant will be selected under the Quality and Cost Based Selection (QCBS) method, the evaluation procedure for which is described in the RFP, and which is in accordance with "MCC Program Procurement Guidelines" which are provided on the MCC website (www.mcc.gov/ppg). The selection process, as described, will include a review and verification of qualifications and past performance, including a reference check, prior to the contract award.
- 8) The minimum qualification required of the consulting firm is described in Section III "Qualification and Evaluation Criteria"
- 9) MFK now invites proposals from legally constituted consulting firms to provide the consultant services referenced above ("Proposals"). More details on these consultant services are provided in the Terms of Reference at Section V of this RFP.
- 10) Consultants wishing to receive the Request for Proposal document in order to submit a proposal, must express their interest, indicating their full contact details, by email to: procurement@millenniumkosovo.org.
- 11) Proposals in hard-copy or in electronic submission must be delivered to the address below and in the manner specified in the PDS ITC 17.3 or Annex 1 to section II Proposal Data Sheet procedure for electronic submission of proposals, **no later than 14.00 Kosovo Time (CET time) of 26 February 2019.**

Office of the Millennium Foundation of Kosovo
Att.: The Procurement Manager
Address: str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana Building, floor IX),
Postal Code: 10000 Prishtina, Kosovo
Email: procurement@millenniumkosovo.org
Phone Number: 00 383 38 752 110
(Phone number is for information only and is not part of the delivery address.)

Consultants should be aware that distance and customs formalities may require longer than expected delivery time. Late Proposals will not be accepted under any circumstances and will be returned unopened at the written request and cost of the Consultant.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Avni Beqiri nga Vushtrria, shpallë të pavlefshme diplomën e Universitetit të Prishtinës në drejtimin e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Metalurgjisë.
- ▶ Dzavid Karadzi shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shf "Meto Bajraktari" Recane
- ▶ Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbulë Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- ▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshohet me qira banesë tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbraja konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehtë qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- ▶ Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshohet banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshohet banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshohet me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshohet banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshohet banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.
- ▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.
- ▶ Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387
- ▶ Lëshohet banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.
- ▶ Lëshohet garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.
- ▶ Lëshohet banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe , një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordnancë. Për informata nr tel; 044/641-524 dhe + 46705793508.
- ▶ Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serrës 4000 metra katrorë. Shefqet Shala, B.I.-Skenderaj. Tel.044-499-713.
- ▶ Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serrës 4000 metra katrorë. Hasan Osmani, B.I.-Skenderaj. Tel. 044-355-579.
- ▶ Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serrës 4000 metra katrorë. Ensari - Bujk, Drenas. Tel. 049-250-828.

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

